# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7619 E hënë 13 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)









Dje në 'Deutsche Welle'

Nga AIDA CAMA

## E pamundur që BE të jetë pro ndryshimit të status quosë territoriale



BE nuk i ka ndryshuar politikat që mbështesin integritetin territorial të Kosovës, thotë Michael Leigh, ekspert për politikat evropiane. Është e pamundur që BE... Vijon në faqen 21



Opinioni i Ditës

Nga REZEARTA ÇAUSHAJ

## Të sëmurët mendorë, një histori personale pa zgjidhje

Nuk para qaj hallet e mia në "Facebook", por përveç ferrit që kemi kaluar dy javët e fundit si familje, njerëzit duhen ndërgjegjësuar me anë të situatave reale... Vijon në faqen 20




Juristi: Tri arsyet e vonesës, si zgjidhet ngërçi në gjyqësor

# Gjata: Tragjike, Shqipëria si në '38 kur Hitleri mbylli Gjykatën Kushtetuese

Flet ish-kreu i KQZ: Parashikimet e "Venecias", disa ambasadorë dolën zbuluar

Nga VALENTINA MADANI

Juristi i njohur Çlirim Gjata denoncon ashpër situatën e krijuar në Gjyqësor teksa akuzon maxhorancën për prekjen e organeve të reja të drejtësisë. Por z.Gjata një njohës i mirë i ligjit thotë për "Gazeta Shqiptare'...

Në faqet 4-5

MASAKRA E SELENICES, VRASESI I 8 VETEVE FILMOI VIKTIMAT PASI I VRAU

# FRIKE NGA HAKMARRJA, ZYKAJT MERREN NE MBROJTJE NGA SHTETI

Kushëriri i Ridvanit: Do të pshurr mbi varr, hajde na vrit dhe ne meqë je trim. Qytetarët: Të rikthehet dënimi me vdekje, nuk ndihemi të sigurt




*(Në foto)* Autori i masakrës, Ridvan Zykaj. Ceremonia mortore e masakrës së Selenicës.

Në faqet 2-3

ZV. MINISTRI I DEL KUNDRA

## Raporti dyvjeçar: 30% e të rinjve shqiptarë janë të papunë, Pulaha: Qeveria s'i mbështet

Në faqen 6

AKUZA E PROKURORISE

## Aksidenti në Kamzë me dy të vdekur, lihet në burg shoferja, avokati: I preu rrugën biçikleta

Në faqen 3

FRANCEZI ZBULON MITET

## Luan Rama: Ekspeditat e arkeologut Heuzey në Shqipërinë e 1860-ës, legjenda dhe rrëfime

Në faqet 18-19

KESHILLAT E YLLI MERJA PER TE KURUAR MENISKUN




## Dr. Tritan Kalo: Rreziqet për shëndetin tonë që lidhen me përdorimin e ushqimeve në vapë

Suplement

Mijëra qytetarë e miliona birra "Korça" të shitura, bilanci i "check in Korça"

# Mbyllet me sukses të madh nata finale e festës së birrës

"Elita 5" qershia mbi tortë e koncertit, ja si shkoi mbrëmja magjike

Me mijëra qytetarë të ardhur nga të gjitha trevat kanë shijuar deri në orët e vona ditën e djeshme në qytetin e Korçës, natën finale të festës së kthyer tashmë në traditë, atë të birrës "Korça". Nën një atmosferë festive, ushqim tradicional dhe shijen e birrës më të mirë




në treg, festës iu bashkuan edhe tingujt e muzikës live, të grupit Elita 5 dhe këngëtarit Vedat Ademi. Nata finale e eventit më madhështor të verës nisi në orën 21:00 për të vazhduar deri në orët e para të mëngjesit. Në këtë vit që përkon me...

Në faqen 9

KOMPENSIMI

## Buxheti, 15 mld lekë për pronarët, 5 mijë përfitues në të gjithë Shqipërinë, lista

Në faqet 10-12

# MASAKRA NË VLORË
## HETIMET



**ÇFARË NDODHI**
Tetë persona, pjesëtarë të dy familjeve të të njëjtit fis u vranë barbarisht në fshatin Resulaj të Selenicës, pasditen e 10 gushtit. Ridvan Zykaj, ka ekzekutuar me kallashnikov 45-vjeçarin Azem Zykaj, 42-vjeçaren Afërdita Zykaj, 75-vjeçarin Demir Zykaj, 72-vjeçaren Perie Zykaj, 43-vjeçarin Besim Zykaj, 42-vjeçaren Vasilika Zykaj, 15-vjeçaren Sara Zykaj dhe 8-vjeçarin Ledjon Zykaj.



**FILMIMET**
Burime pranë grupit hetimor bënë me dije se në telefonin e autorit janë gjetur video të viktimave pas ekzekutimit barbar. Gjithashtu, mësohet se videon e regjistruar me viktimat e shtrirë në oborret e banesave, 24-vjeçari Zykaj ia nisi një të afërmi në rrjetin social në Messenger-in e "Facebook"-ut.



**EKSPERTIZA**
Autoritetet po e mbajnë Zykajn në ambientet e Policisë së Vlorës dhe pritet që ai të dalë ditën e sotme para gjykatës për masë sigurie. Ndërsa prokuroria ka kërkuar një ekspertizë mjekësore për të vërtetuar nëse ka apo jo probleme mendore, por deri tani zyrtarisht nuk konfirmohet nëse ka apo jo.


Ceremonia mortore e masakrës së Selenicës

Qytetarët: Të rikthehet dënimi me vdekje, nuk ndihemi të sigurt

# Masakra e Selenicës, autori filmoi viktimat pas ekzekutimit

*Policia gjen videot makabër në celularin e Ridvan Zykajt*

**VLORE**

Dy ditë pas ngjarjes makabër me tetë të vrarë në Resulaj të Selenicës, të tjera detaje dalin në dritë. Mësohet se autori i masakrës, Ridvan Zykaj, pas krimit të rëndë, ka filmuar me telefonin e tij pasojat tragjike. Burime pranë grupit hetimor bënë me dije se në telefonin e autorit janë gjetur video të viktimave pas ekzekutimit barbar. Gjithashtu, mësohet se videon e regjistruar me viktimat e shtrirë në oborret e banesave, 24-vjeçari Zykaj ia nisi një të afërmi në rrjetin social në messenger-in e "Facebook"-ut. Autoritetet po e mbajnë Zykajn në ambientet e policisë së Vlorës dhe pritet që ai të dalë ditën e sotme para gjykatës për masë sigurie. Ndërkohë prokuroria ka kërkuar arrest me burg deri në përfundim të hetimeve. Gjithashtu organi i akuzës ka kërkuar një ekspertizë mjekësore për të vërtetuar nëse ka apo jo probleme mendore, por deri tani zyrtarisht nuk konfirmohet nëse ka apo jo. Kujtojmë se pas arrestimit, siç blutë e Vlorës konfirmojnë, autori i krimit nuk ka shfaqur pendesë. Pranoi krimin e kryer për shkak se sipas tij, e kishin akuzuar për vjedhjen e disa pulave. Ai nuk bëri rezistencë ndaj forcave të rendit ndërsa iu sekuestruar arma e krimit automatik kallashnikov dhe telefoni celular. Më tej, ai kërkoi një avokat. Në fshat 24-vjeçari njihej si person problematik, për shkak të sherreve të vazhdueshme që bënte me të tjerët. Disa ngrenë dyshime se ai mund të ketë pasur edhe probleme të shëndetit mendor. Mësohet se gjendja e tij së fundmi kishte pësuar përkeqësim, aq sa nuk pranonte të jetonte më as me prindërit e tij. Ndonëse në të njëjtën çati, Ridvani jetonte në një dhomë të veçuar dhe nuk përzihej as me ta, as me të vëllanë dhe motrën.


Autori i masakrës, Ridvan Zykaj

**KUSHËRIRI I VIKTIMAVE**
Një nga kushërinjtë e viktimave që Zykaj u mori jetën i ka shkruar në rrjetic social facebook, duke e paralajmëruar për vdekjen e tij. "Gjyshja ime po vuan sonte sepse i ke vrarë vëllain bashkë me fëmijët, hajde të na vrasësh dhe neve, jemi para shtëpisë tënde meqë je kaq trim", ka shkruar kushëriri i viktimave.

### REAGIMI I QYTETARËVE

Masakra e Selenicës ka rikthyer debatin nëse duhet ashpërsuar legjislacioni për personat që kryejnë krime monstruoze. Gjate reagimeve të dhëna, qytetarët shprehen se ndjehen të pambrojtur, duke theksuar se këtë masakër e dënojnë me vdekje. "Duhet të jetë dënimi me vdekje. Çfarë është kjo? Armëmbajtje pa leje që të bëjnë pazar, gjykatësit dhe prokurorët? Nuk e shef se çfarë po bëhet për vendimet në drejtësi. Duhet të jetë dën-

## Frikë nga hakmarrja. Largohen nga banesa familjarët e vrasësit Zykaj, policia i merr në mbrojtje

Frika e hakmarrjes ka larguar nga banesa në Resulaj të Selenicës, prindërit, vëllain dhe motrën e autorit të vrasjes së 8 kushërinjve. Menjëherë pas ngjarjes tragjike policia ka marrë në mbrojtje familjen e vrasësit Ridvan Zukaj. Forcat e policisë përgatitën një plan mbrojtje për familjarët e Zykës, duke i larguar nga zona ku jetonin. Para masakrës, familjet nga i njëjti fis jetonin pranë njëra-tjetrës. Një ditë pasi iu dha lamtumira e fundit 8 viktimave, në fshat njerëzit nuk vazhdojnë jetën normalisht. Ata ende janë në orët e pikëllimit dhe flasin për atë që ka ndodhur. Në ceremoninë e varrimit të viktimave të masakrës së Selenicës mungoi familja e autorit të krimit. Gjithashtu, këshilli bashkiak vendosi të shpallë të hënën, dite zie dhe ka akorduar një fond prej 12 milionë lekësh për mbulimin e shpenzimeve të varrimit. Mësohet se 5 nga viktimat e mbrëmshme kanë qenë me ndihmë sociale nga Bashkia e Selenicës për shkak të vështirësive ekonomike. Ditën e shtunë mes lotëve të afërmit dhe i gjithë fshati përcollën familjen Zykaj për në banesën e fundit. Më e dhimbshme për familjarët ka qenë mbajtja dhe varrosja e dy fëmijëve të mitur të familjes. Sara dhe Ledjoni, me dy arkivolë të bardhë, prehen tashmë me gjithë familjen e tyre, fare pranë shtëpisë ku jetuan për ato pak vite. Pas tragjedisë, familjarët e viktimave gjetën forcën që pas varrimit të japin një mesazh sensibilizues për të gjithë të rinjtë shqiptarë. "Askund nuk është parë një krim i tillë. Kjo është një gjëmë. T'u qëndrojmë pranë të rinjve për të mos bërë veprime të tilla. Shteti t'i gjejë vendin kriminelit", u shpreh një pjesëtar i familjarëve mes dhimbjes dhe lotëve.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415***-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



**EMRAT DHE LIDHJET E VIKTIMAVE ME NJERI-TJETRIN**

1- Demir Zykaj, 75 vjeç (Vëllai i gjyshit të autorit)
2- Perrie Zykaj, 78 vjeç, (Gruaja e Demirit)
3- Besim Zykaj, 42 vjeç (Djali i Demirit)
4- Vasilika Zykaj 40-vjeç, (Gruaja e Besimit)
5- Sara Zykaj, 15 vjeç (Vajza e Besimit)
6- Ledjon Zykaj, 8 vjeç (Djali i Besimit)
7- Azem Zykaj 49-vjeç (Djali i Demirit)
8- Afërdita Zykaj 47-vjeç (Gruaja e Azemit)

imi, sepse nuk do guxonin të merreshin me shumë gjëra. Unë kështu mendoj dënimi me vdekje duhet te jetë kapital, është problem tjetër nëse nuk duan qeveritarët, atëherë ata e kanë problemin e familjeve te tyre", thotë një qytetar. Pasiguria për jetën është arsyeja kryesore, sepse shqiptarët kërkojnë rikthimin e dënimit kapital. "Nuk ndihem shumë i sigurtë, dita ditës po e shohim çfarë bëhet. Kam frikë, për fëmijët më tepër", shprehet një tjetër qytetar.

**NGJARJA**

Pasditen e 10 gushtit, është shënuar një ndër ngjarjet më të rënda kriminale në vendin tonë. Tetë persona, pjesëtarë të dy familjeve të të njëjtit fis janë vrarë në fshatin Resulaj të Selenicës, duke shënuar kështu një masakër që ka shokuar jo vetëm banorët e zonës, por të gjithë opinionin publik. Autori i ngjarjes së rëndë Ridvan Zykaj, ka ekzekutuar me kallashnikov 45-vjeçarin Azem Zykaj, 42-vjeçaren Afërdita Zykaj, 75-vjeçarin Demir Zykaj, 72-vjeçaren Perie Zykaj, 43-vjeçarin Besim Zykaj, 42-vjeçaren Vasilika Zykaj, 15-vjeçaren Sara Zykaj dhe 8-vjeçarin Ledjon Zykaj. Me kallashnikov në dorë Ridvan Zykaj ka hyrë fillimisht në banesën e Besim Zykajt, të cilin e ka gjetur në shkallët e banesës ku dhe e ka vrarë, e më pas bashkëshorten e tij. Nuk është mjaftuar me kaq pasi ai ka qëlluar pa mëshirë edhe mbi dy kushërinjtë e tij, Sarën dhe Ledjonin. Më tej vrasësi është drejtuar tek shtëpia e vëllait tjetër, Azemit ku e ka lënë të vdekur në vend atë së bashku me bashkëshorten. Destinacioni i fundit për 24-vjeçarin ka qenë shtëpia e Demirit, babai i dy viktimave. Ridvani mësohet se ka qëlluar në drejtim të Demirit, i cili qëndronte në divan në ballkonin e shtëpisë dhe më pas ka shkuar në drejtim të gruas së tij, duke e lënë edhe atë të vdekur në vend. Viktimat kanë pasur plagë të shumta nga plumbat e kallashnikovit, kryesisht në bust dhe në kokë. Kësaj masakre kanë mundur t'i shpëtojnë vetëm tre djem të familjes Zykaj, të cilët nuk ndodheshin në shtëpi. Konkretisht nga familja e Besimit ka shpëtuar vetëm një djalë, Albi Zykaj(punonte në një restorant në Vlorë), ndërsa nga familja e Azemit dy djem, njëri nga të cilët ndodhet në Greqi. Kujtojmë se 24-vjeçari arriti të arrestohej nga uniformat blu as 12 orësh në arrati. Konkretisht autori I kësaj masakre ra në prangat e policisë mëngjesin e së shtunës.

Prokuroria ngre dyshime se 38-vjeçarja në vend që të frenonte, i ka dhënë gaz

# Aksidenti në Kamzë me dy të vdekur, lihet në burg shoferja

## *Avokati: Rozina Kolecit i preu rrugën biçikleta*

Gjykata e Tiranës zhvilloi ditën e djeshme seancën gjyqësore ndaj Rozina Kolecit, 38-vjeçaren, e cila shkaktoi aksidentin tragjik të 8 gushtit në Kodër Kamzë. Ndaj Kolecit u dha masa e sigurisë "arrest me burg". Këtë masë sigurie kishte kërkuar edhe prokurorja e Tiranës, e cila po vijon hetimet për këtë ngjarje. 38-vjeçarja teksa drejtonte automjetin tip "Benz" me targë AA071UA, ka humbur kontrollin e drejtimit të mjetit, duke u përplasur me një biçikletë. Pas kësaj makina ka përplasur edhe një nënë me dy fëmijë të mitur. Si pasojë e përplasjes së fortë ka ndërruar jetë njëra nga vajzat, një 7-vjeçare dhe shtetasi i identifikuar si Ramazan Isha, 29 vjeç, i cili ishte duke drejtuar biçikletën ne momentin e aksidentit. Makina është përplasur më pas dhe me një furgon të bardhë. Gjatë seancës së vlerësimit të masës së sigurisë të zhvilluar paraditen e së shtunës Koleci nuk ka folur para trupit gjykues, ndërsa avokati i saj ka sqaruar rrethanat e pretenduara nga e mbrojtura prej tij. Sipas avokatit të Rozina Kolecit, kjo e fundit ka humbur drejtimin e automjetit me të cilin po lëvizte, kur i ka dalë befasisht përballë i riu me biçikletë që mbeti viktimë e këtij aksidenti, 29 vjeçari Ramazan Isha. Avokati ka sqaruar se në përpjekje për të shmangur përplasjen me biçiklistin gruaja ka përplasur fatalisht dhe nënën me dy vajzat, njëra prej të cilave, 7 vjeçe, tragjikisht humbi jetën. Ndryshe dyshon prokuroria se ka qenë dinamika e ngjarjes. Mësohet se organi i akuzës do të sekuestrojë videot e kamerave të bizneseve në zonën e aksidentit për të provuar dyshimin se 38-vjeçarja Rozina Koleci, në vend që të frenonte në momentin e aksidentit padashje i ka dhënë gaz. Prokuroria ka, gjithashtu, dyshimin se autorja e aksidentit tragjik ka qenë duke komunikuar me celular në momentin që tragjikisht ka humbur kontrollin e makinës. Kujtojmë se ditën e aksidentit të rëndë, dëshmitarët në vendngjarje thanë se ishte drejtuesja e mjetit tip "Benz" që doli nga rruga, duke marrë përpara biçikletën dhe këmbësorët.




Aksidenti i ndodhur në Kodër Kamzë

Pasi doli në korsinë tjetër të rrugës, makina u përplas edhe me një mjet tip furgon. Shoferi i furgonit me të cilin u përplas makina, pasi kishte përplasur fillimisht 29-vjeçarin Ramazan Isha dhe nënën me dy fëmijë, tregon momentet e tmerrit që përjetoi. Ai tregoi momentin tragjik, kur makina përplasi nënën me 2 vajzat e saj. Fëmijët ishin në trotuar. Pashë vetëm momentin kur makina i ra gruas dhe dy fëmijëve. Nuk pashë biçikletën. Makina nuk ishte me shpejtësi, ishte normal. Fëmija ishte i vdekur para makinës tonë dhe çiklisti ishte i vdekur pak më tutje. U tmerruam, të shohësh viktima. Ishin pamje të tmerrshme", u shpreh drejtuesi i furgonit.

**AVOKATI**

Sipas avokatit të Rozina Kolecit, kjo e fundit ka humbur drejtimin e automjetit me të cilin po lëvizte, kur i ka dalë befasisht përballë i riu me biçikletë që mbeti viktimë e këtij aksidenti, 2- vjeçari Ramazan Isha. Avokati ka sqaruar se në përpjekje për të shmangur përplasjen me biçiklistin gruaja ka përplasur fatalisht dhe nënën me dy vajzat, njëra prej të cilave, 7 vjeçe, tragjikisht humbi jetën.

**MASA E SIGURISË**

Ndaj Rozina Kolecit u dha masa e sigurisë "arrest me burg". Këtë masë sigurie kishte kërkuar edhe prokurorja e Tiranës, e cila po vijon hetimet për këtë ngjarje.

Arrestohet autori shtetasi Ylli Shabanaj

# Plagosje me thikë në mes të Shkodrës, dërgohet në spital 50-vjeçari



**SHKODER-** Një plagosje me thikë ka ndodhur ditën e djeshme në qytetin e Shkodrës. Ngjarja ka ndodhur në lagjen "Partizani", pas një konflikti mes dy personave. Për pasojë ka mbetur i plagosur shtetasi me inicialet SH.A 50 vjeç, i cili është dërguar menjëherë në spitalin e Shkodrës për të marrë ndihmën mjekësore. Nga informacionet e paraprake, mësohet se ngjarja ka ndodhur në një lokal në lagjen "Partizani" për motive të dobëta. "Falë veprimeve të shpejta operacionale dhe hetimore të policisë, u bë e mundur kapja dhe ndalimi i autorit të dyshuar, shtetasit: Ylli Shabanaj, 44 vjeç, banues në lagjen "Partizani" Shkodër", thuhet në njoftimin e policisë. Materialet do i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkoder për veprat penale të "Vrasja me dashje e mbetur në tentative" e "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e arme¨ve te¨ ftohta"

GAZETA SHQIPTARE

# KRIZA NË GJYQËSOR

## INTERVISTA

### Reforma në drejtësi, juristi: Tri arsyet e vonesës, si zgjidhet ngërçi në gjyqësor

# Gjata: Tragjike, Shqipëria si në '38, kur Hitleri mbylli Kushtetuesen

## "Mungesa e gjykatave, qeveria mbetet pa kontroll"

Valentina Madani

*Juristi i njohur Çlirim Gjata denoncon ashpër situatën e krijuar në Gjyqësor teksa akuzon maxhorancën për prekjen e organeve të reja të drejtësisë. Por z.Gjata një njohës i mirë i ligjit thotë për "Gazeta Shqiptare' se kjo u bë edhe me ndihmën e kritikueshme të faktorit ndërkombëtar në Tiranë duke i kujtuar se shteti nuk bëhet shteti me makinacione politike, por me kompromis historik.*

*Ai shpreh shqetësimin se "jemi i pari vend në Europë pas luftës së dytë botërore ku mbyllet Gjykata Kushtetuese. Ka ndodhur vetëm në `38 kur Hitleri mbylli Gjykatën Kushtetuese austriake. Edhe kryetari aktual pret një proces tjetër vetingu në KPA. Ka mbetur vetëm një anëtar, por që edhe këtij i ka mbaruar mandati". Sipas Çlirim Gjatës nga mungesa e gjykatave humbasin të gjithë, me përjashtim të qeverisë pasi kjo mungesë i ka hequr kontrollin qeverisë tonë dhe praktikisht demokracia ka rënë. Si zgjidhje ai kërkon: "Të hartohen dispozita kalimtare kushtetuese, për funksionimin e institucioneve të larta gjyqësore, që sot mungojnë, në mënyrë të përkohshme derisa të përfundojë vetingu dhe sistemi i ri drejtësisë të bëhet aktiv. Gjithmonë me Kushtetutë dhe jo me 69 vota politike. Këtu duhet të përfshihet edhe zgjidhja e konfliktit politik me Prokuroren e Përgjithshme, e cila është antikushtetuese, si dhe emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nëpër organet më të ulta të drejtësisë të mbetura bosh nga vetingu, apo dhe kandidatëve për magjistratë". Kjo shprehet Gjata, nuk bëhet me arnime ligjesh në mënyrë politike, për interesa partiake. "As ashtu si thoshte Z.Han, "hajt votoni", por me Kushtetutë, me përgjegjësi për vendin dhe qytetarët", deklaron juristi Çlirim Gjata.*



Juristi Çlirim Gjata

**Z.Gjata përse kaq shumë vonesa në zbatimin e reformës në drejtësi, pse nuk po funksionojnë organet e reja të drejtësisë?**

Fatkeqësisht jemi dy vjet nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese, ku u shfuqizua i gjithë sistemi i vjetër në drejtësi dhe u ndërtua në letrën kushtetuese një sistem tërësisht i ri. Dhe nuk mund të mos e them, një sistem i ri drejtësie i paprecedent në botën demokratike, një sistem eksperimental, që testohet për herë të parë në Shqipëri. Ndaj dhe natyrisht, që nuk do t'i shpëtonte vonesave, pasi askush nuk ka përvojë implementuese, madje as ndërkombëtarët. Arsye tjetër vonesë është edhe arsyeja politike. Mendoj se kjo maxhorancë, shfrytëzoi çdo moment për të futur duart në reformë, për të prekur organet e reja të drejtësisë dhe duhet përmendur se kjo u bë edhe me ndihmën e kritikueshme të faktorit ndërkombëtar në Tirane. Arsyeja e tretë është procesi i vetingut. Jo për faj të vetë vetingut, sepse askush nuk e parashikoi se sa do të zgjatë, por për paaftësi të atyre që e ndërtuan reformën(nuk po them dashakeqësi, sepse nuk dua ta besoj). Duhej të kishin parashikuar pasojat e vetingut dhe të kishin ndërtuar skema për funksionimin e përkohshëm të institucioneve, që prekeshin nga vetingu. Vetingu duhej të fillonte nga baza e drejtësisë jo nga kreu. Këtë situatë e shfrytëzoi mazhoranca politike për interesat e saj.

**Pse sot Shqipëria është pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatë të Lartë? Kam parasysh këtu që Kushtetuesja është aktualisht jashtë loje. Drejt të njëjtit fat rrezikon të shkojë dhe Gjykata e Lartë, e cila tashmë funksionon me numër të kufizuar të anëtarëve të saj, ndërsa mungesa e Këshillit të Lartë të Prokurorisë po mban pezull dhe Byronë Kombëtare të Hetimit dhe SPAK-un ose njësinë speciale antikorrupsion.**

Jemi i pari vend në Europë pas Luftës së Dytë Botërore ku mbyllet Gjykata Kushtetuese. Ka ndodhur vetëm në `38 kur Hitleri mbylli Gjykatën Kushtetuese austriake. Edhe kryetari aktual pret një proces tjetër vetingu në KPA. Ka mbetur vetëm një anëtar, por që edhe këtij i ka mbaruar mandati. Kjo ngjan edhe komike, të paktën ajo e Hitlerit ishte tragjedi. Ndërsa Gjykata e Lartë nga 19 anëtarë ka mbetur me katër. Ndërkohë nuk janë krijuar asnjë nga institucionet kushtetuese të sistemit të ri të drejtësisë. Deri tani ky është "suksesi" i reformës në drejtësi. Dhe nuk ka asnjë parashikim nga askush, se kur mund të ngrihen dhe kur do të bëhet funksional sistemi i ri i drejtësisë. Këto pasoja vijnë kur reformat bëhen në mënyrë eksperimentale dhe për interesa politike. Dhe kemi mbetur këtu ku jemi. Pasi duhet të ndërtohet KLP për të ngritur SPAKUN dhe BKH, të cilat do të luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar. Gjithashtu, KLP do të ndërtojë sistemin e ri të prokurorisë në mbarë vendin dhe emërojë Prokurorin e Përgjithshëm. Ndërsa ngritja e KLGJ do të sjellë ndërtimin e Gjykatës Speciale që do të dënojë të korruptuarit dhe mafiozët. Më thoni, ju lutem, si mund të jetë politika qeveritare e interesuar për ndërtimin e këtyre institucioneve?! Pastaj vazhdojmë me rindërtimin e gjithë sistemit gjyqësor po nga KLGJ, deri dhe Gjykatën e Lartë. Dhe nga kjo e fundit do të dalin vetëm tre anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Paralel me këto duhet të krijohet edhe KED, që do t'i propozojë parlamentit dhe presidentit kandidaturat për 6 vende në Gjykatën Kushtetuese, si dhe do të emërojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, që kontrollon abuzimet e prokurorëve dhe gjyqtarëve. Dhe të gjitha këto presin vetingun. Se kur do të mbarojë kjo dramë, që quhet reformë në drejtësi nuk e di.

**QEVERIA**

"Kur vendi mbetet pa gjykata si po ndodh këtu tek ne, humbasin të gjithë. Humbasin qytetarët, biznesi, ekonomia, familjet, gjithçka shkon me humbje. Humbet demokracia, Kushtetuta, ndarja dhe balancimi i pushteteve, të drejtat kushtetuese të njeriut. Për të fituar, fiton vetëm qeveria",-u shpreh z.Gjata.

**Opozita akuzon kryeministrin Rama për bllokimin e këtyre dy gjykatave për interesat e saj klanore...**

Kur vendi mbetet pa gjykata si po ndodh këtu tek ne, humbasin të gjithë. Humbasin qytetarët, biznesi, ekonomia, familjet, gjithçka shkon me humbje. Humbet demokracia, Kushtetuta, ndarja dhe balancimi i pushteteve, të drejtat kushtetuese të njeriut. Për të fituar, fiton vetëm qeveria. Dhe jo vetëm këtu te ne, por po të ndodhte kudo kjo që po ndodh, fituese do të ishte vetëm qeveria. Sepse në këto kushte, qeverinë nuk ka se kush e kontrollon. Demokracia funksionon mbi kontrollin institucional dhe barazinë e pushteteve. Mungesa e gjykatave i ka hequr kontrollin qeverisë tonë dhe praktikisht demokracia ka rënë. Vendet demokratike nuk ja lejojnë vetes t'i ndodhin këto, sepse kanë demokraci tradicionale, por ndërkohë nuk duhej të lejonin që, edhe në Shqipëri të ndodhnin, pasi ekspertët e tyre (Euralius dhe OPDAT) duhej të kishin ndikuar për të kundërtën. Mjaftojnë 5 ditë pa Gjykatë Kushtetuese për qeverinë, e jo më me vite. Shikoni ligjin për teatrin dhe argumentet kushtetues dhe ligjore për kthimin e tij nga presidenti. Është një interes i pastër klanor nga ana e qeverisë ku nga shfrytëzimi i pronës publike dhe shkatërrimi i monumenteve të kulturës, do të përfitohen 200 milionë euro. Dhe jo për publikun, por për klanet qeveritare. Ku është Gjykata Kushtetuese, që ta ndalojë këtë? Merrni marrëveshjen e detit. Kush garanton se është më e mirë se e para?! Por, për këtë duhet Gjykata Kushtetuese dhe në mungesë të saj mund të kemi një marrëveshje, që cenon integritetin territorial të Shqipërisë. Po sa raste të tjera të ngjashme, por që nuk merren vesh, sepse nuk kanë impakt publik, po abuzohen nga qeveria? Ndaj, mendoj se opozita ka të drejtë.



Gjatë një seance parlamentare

**Çfarë pasojash ka për vendin tonë mungesa e këtyre dy gjykatave dhe si mund të zgjidhet situata bllokuese në gjyqësor?**

Pasojat pak a shumë i preka më lart. Për sa i takon zgjidhjes së kolapsit në gjyqësor, mendoj se kërkon një kompromis të madh politik. Të hartohen dispozita kalimtare kushtetuese, për funksionimin e institucioneve të larta gjyqësore, që sot mungojnë, në mënyrë të përkohshme derisa të përfundojë vetingu dhe sistemi i ri drejtësisë të bëhet aktiv. Gjithmonë me Kushtetutë dhe jo me 69 vota politike. Këtu duhet të përfshihet edhe zgjidhja e konfliktit politik me Prokuroren e Përgjithshme, e cila është antikushtetuese, si dhe emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve



### Ngërçi në gjyqësor, presidenti: Duhet dialog politik

## Meta: Nxitja e konflikteve nuk i shërben implementimit të reformës në drejtësi

Në një kohë kur institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë janë në kushtet e mosfunksionimit, presidenti Ilir Meta shprehet për herë të parë për ligjin e magjistraturës duke kërkuar dialog politik. Meta deklaroi dy javë më parë se nxitja e konflikteve nuk i shërben implementimit të reformës në drejtësi. "Unë jam i bindur se nxitja e konfliktit as nuk i ka shërbyer deri më tani reformës në drejtësi, dhe as nuk do t'i shërbejë në të ardhmen. Vendi ka nevojë për një reformë në drejtësi, e cila bazohet fort te pavarësia e institucioneve të reja të drejtësisë, te integriteti i krijimit të tyre. Dhe në këtë drejtim unë inkurajoj vetëm dialogun për të zgjidhur çdo çështje në mënyrën më transparente dhe me integritet", tha ai. Meta u ndal dhe te Gjykata Kushtetuese. "Besoj se duhen të ndërmerren sa më parë të gjitha ato hapa, që përforcojnë efektet pozitive të reformës në drejtësi, por pa krijuar kurrsesi boshllëk apo paralizë të institucioneve më të rëndësishme të drejtësisë",-theksoi kreu i shtetit.



"A do të guxonte Z.Han, në rastin gjerman të thoshte "hajt votoni"? Në rastin shqiptar, ngjan pak raciste".

# Zgjidhja për gjyqësorin, juristi: Dispozita kalimtare kushtetuese

## "Parashikimet e 'Venecias', disa ambasadorë dolën zbuluar"

### Gjykata e Lartë në ngërç, mbeten të bllokuara 26 500 çështje gjyqësore

Sallat e Gjykatës së Lartë janë mbyllur me çelës. Kolegjet penale nuk funksionojnë më, për sa kohë dy gjyqtarët Artan Zeneli e Tom Ndreca u shkarkuan. Kolegji Penal ka mbetur me vetëm një anëtar, që është Edmond Islamaj. Lista e proceseve penale të anuluara apo të shtyra pa afat është e gjatë. Korridoret janë bosh, nuk ka as avokatë, as palë që presin procese. Në një situatë normale dhe bindjeje ndaj ligjit, Gjykata e Lartë duhet të kishte 19 anëtarë. Por tashmë janë 6 anëtarë, prej të cilëve kanë fituar 3 anëtarë garën e vetingut dhe tre të tjerë presin. Në mes të asgjësë ka mbetur edhe lutja e Nënë Terezës drejtuar gjyqtarëve për të dëgjuar e thënë të vërtetën sepse ata që kaluan vetingun do t'u duhet të mblidhen në dhomat e këshillimit për të vendosur për çështje emergjente si masat e sigurimit apo urdhrat e ekzekutimit. Tre të tjerët që po presin kanë përpara sfidën e vetingut. Por e gjitha kjo përkthehet në një situatë ku stoku i dosjeve dhe i qytetarëve në Gjykatën e Lartë shtohet përditë. Brenda një muaji, fluksi është rritur në 26 500 çështje të pashqyrtuara ende. Por, edhe vjeshta do të jetë akoma më e vështirë për ata që do të kërkojnë drejtësi. Sepse plotësimi i këtyre karrigeve do të vijë vetëm pasi drejtësia të ketë qeverinë e saj, Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

nëpër organet më të ulta të drejtësisë të mbetura bosh nga vetingu, apo dhe kandidatëve për magjistratë. Kjo nuk bëhet me arnime ligjesh në mënyrë politike, për interesa partiake. As ashtu si thoshte Z.Han, "hajt votoni", por me Kushtetutë, me përgjegjësi për vendin dhe qytetarët.

**Parlamenti dështoi në votimin për disa ndryshime në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat synojnë t'i hapin rrugë pranimeve të reja në shkollën e magjistraturës dhe emërimeve të magjistratëve të rinj të diplomuar tanimë. Shkak është bërë opozita. Konkretisht si mund të zgjidhet ngërçi me Shkollën e Magjistraturës?**

Nuk mendoj se shkak u bë opozita, megjithatë është një pikë që duhet ta debatoni me opozitën. Mendoj se shkaku ndodhet te reforma, e cila nuk i shpëtoi interesit politik të momentit. Ka dy vjet që është miratuar reforma kushtetuese dhe nuk kemi asnjë institucion, përkundrazi jemi i vetmi vend në Europë pa instanca të larta gjyqësore. Dhe tani, pas dy vjetësh, duhet miratuar një projektligj me dispozita kalimtare, që vjen tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën dhe na kthen në procedurat e para 2016, pra në sistemin e vjetër. Si mund të miratohen procedura ligjore të shfuqizuara nga Kushtetuta e vjetër dhe që vijnë në kundërshtim me të renë? Pse nuk sqarojnë publikun, se përse nuk funksionon sistemi i ri i drejtësisë; përse nuk është ngritur asnjë institucion i drejtësisë dhe se kur janë gjasat që të ngrihen; përse jemi pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatë të Lartë; përse kemi një Prokuror të Përgjithshëm politik dhe antikushtetues; pra si mund të anashkalohen të gjitha këto dhe të votohet një projekt ligj kalimtar nën moton "hajt votoni". Apo sepse kjo situatë i shërben qeverisë jo për të qeverisur, por për të sunduar nëpërmjet përfitimit vetjak financiar.

Megjithatë ndërkombëtarët në mënyrë të vazhdueshme i kanë bërë apel opozitës për miratimin e këtyre ndryshimeve...

Ndërkombëtarët kanë mbetur te metoda "hajt votoni". Hajt votoni se Shqipëri është këtu, hajt votoni se për shqiptarët janë këto, kuptohet jo për gjermanët. Ndërkombëtarëve, ju gazetarët, mendoj se duhet t'i bëni një pyetje: a do ta lejonin të ndodhnin në vendet e tyre, këto që po ndodhin në Shqipëri edhe me miratimin e tyre? Çfarë do të bënte Gjermania nëse një ditë, qoftë dhe për një arsye objektive, do të mbetej pa Gjykatë Kushtetuese? A do të guxonte Z.Han, në rastin gjerman të përdorte shprehjen "hajt votoni"? E pra në rastin shqiptar ata s`e kanë problem. Kjo ngjan pak raciste. Pse ndërkombëtarët nuk vënë sot në kandar atë që Komisioni i Venecias parashikoi për pasojat që do të sillte vetingu dhe për ndërlikimet e sistemit të ri të drejtësisë? Koha i provoi parashikimet e Venecias dhe disa ambasadorë kanë dalë zbuluar. Përvoja e këtyre 28 viteve na mëson se duhet hequr dorë përfundimisht nga zgjidhjet e shkurtra, kalimtare, nga zgjidhjet e vogla me interes politik, aty për aty, por që lënë pasoja negative në të ardhmen e vendit. Duhen zgjidhje themelore, te forta që t'i rezistojnë kohës dhe t'i shërbejnë zhvillimit të vendit. Si në Europë.

**Miratimi i këtyre ndryshimeve a do të zhbllokonte dot situatën e krijuar nga mungesa e institucioneve të reja të parashikuara nga reforma në drejtësi, pasi kërkon 84 vota, të cilat shumica socialiste, e vetme, nuk i ka? Cila do të ishte zgjidhja juridike në këtë rast?**

Asnjë situatë nuk do të zhbllokonte miratimi i këtyre dispozitave, sepse ato nuk flasin kund për Gjykatë Kushtetuese apo të Lartë. Nuk flasin kund për Prokuror të Përgjithshëm, por thjeshtë për gjykatës e prokurorë të niveleve më të ulta dhe studentë të Shkollës së Magjistraturës. A thua se këta janë problemi. Këta pritet që të jenë një problem, por akoma jo aktuali dhe jo më i madhi. Përse mazhoranca nuk bën përpjekje për institucionet e larta të munguara? Sepse asaj i intereson ky boshllëk institucional në drejtësi. Ndërsa për sa i takon niveleve të ulta për të cilat kërkohet votimi i ligjit, janë pikërisht këto makinacione ligjore, që i mundësojnë mazhorancës të ketë në dorë gjyqtarët dhe prokurorët e rinj, madje që nga studentët e magjistraturës. Habitem se si ndërkombëtarët nuk i denoncojnë këto, por thonë "hajt votoni". Nuk bëhet shteti me makinacione politike, por me kompromis historik.



Gjykata e Lartë

**KUSHTETUESJA**

"Jemi i pari vend në Europë pas Luftës së Dytë Botërore ku mbyllet Gjykata Kushtetuese. Ka ndodhur vetëm në `38 kur Hitleri mbylli Gjykatën Kushtetuese Austriake. Edhe kryetari aktual pret një proces tjetër vetingu në KPA. Ka mbetur vetëm një anëtar, por që edhe këtij i ka mbaruar mandati. Kjo ngjan edhe komike, të paktën ajo e Hitlerit ishte tragjedi. Ndërsa Gjykata e Lartë nga 19 anëtarë ka mbetur me katër",-tha z.Gjata.

**Si i konsideroni vendimet e fundit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit për prokurorët dhe gjyqtarët, të cilët janë konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit?**

Nga pikëpamja formale ONM bën vëzhgime dhe jep sugjerime. Nuk ka të drejtë vendimmarrjeje, kështu që ankimimi i takon komisionerit publik. ONM thjesht i propozon komisionerit publik të ushtrojë ankim mbi një apo disa raste të caktuara. Problemi më i madh në procesin e vetingut qëndron te KPK, te cilësia e punës së saj. Ka mungesë transparence. Nëse dalin dokumente komprometuese për një subjekt a një tjetër ato duhen bërë publike. Edhe nëse nuk qëndrojnë ligjërisht përsëri duhen bërë publike dhe të argumentohet, se përse nuk qëndrojnë. Moment tjetër është ai i dy standardeve të mbajtur nga KPK në vlerësimin e kontrolleve. Sidomos në çështjet e pasurisë. Janë larguar nga detyra subjekte, për mos justifikim të një mase të caktuar pasurie, ndërkohë që janë mbajtur në detyrë subjekte të tjerë edhe pse nuk kanë justifikuar një masë më të madhe pasurie se të shkarkuarit. Kjo ka rënë në sy tepër dhe nuk mendoj, se ka të bëjë më pasurinë, por me individin. Duket sikur, kush është i lidhur konjukturalisht me qeverinë, shpëton. Momenti i fundit, që vlen për diskutim është ai ku, KPK është përqendruar vetëm në trajtimin e pasurisë, duke mos hetuar pothuajse fare në cilësinë e punës së gjyqtarëve apo prokurorëve. E pra, qytetarët i kanë dërguar KPK raste gjykimesh abuzive pa fund, me emra dhe me dosje. Në këtë pikë KPK po tregohet e paaftë profesionalisht dhe e ka kufizuar misionin e vet, vetëm në një audit financiar.

**VOTIMI**

"Habitem se si ndërkombëtarët nuk i denoncojnë këto, por thonë "hajt votoni". Nuk bëhet shteti me makinacione politike, por me kompromis historik",- deklaroi juristi Çlirim Gjata.

**Si e shikoni drejtimin e Prokurorisë së Përgjithshme nga Arta Marku dhe a po shkon ajo nga kryeprokurore e përkohshme, drejt kryeprokurores së përhershme? Si mund ta bllokojë opozita mandatin e saj?**

Për Prokuroren e Përgjithshme kemi folur shumë herë. Së pari, ajo është zgjedhur në mënyrë antikushtetuese. Se dyti, është zgjedhur politikisht, pra është e kapur nga mazhoranca politike. Se treti, ka tejkaluar kompetencat duke marrë mbi vete kompetenca që nuk i ka me ligj. Kjo quhet shpërdorim detyre. Se sa do të zgjasë përkohshmëria e saj, këtë askush nuk di ta thotë. Këto ndodhin kur gjërat bëhen në kundërshtim me ligjin. Ajo që është e rëndësishme në këtë histori të "përkohshme", mbetet fakti se, për të krijuar KLP ka shumë në dorë kjo prokurore. Ajo thërret konferencën e përgjithshme të prokurorëve nga e cila zgjidhen 6 anëtarë të KLP. Ka në dorë ngritjen komisionit të votimit dhe procedurat e tij. Lobimin deri me shantazhe, për ata që duhen votuar. Praktikisht ka në dorë emrat e 6 anëtarëve të KLP, të cilët së bashku me pesëshen e zgjedhur nga parlamenti do të formojnë institucionin më të rëndësishëm të prokurorisë. Pra, KLP rrezikon të kapet nga mazhoranca e sotme ku 5 anëtarë vijnë nga kjo e fundit dhe 6 anëtarë nga prokurorja në detyrë e zgjedhur dhe kjo nga e njëjta mazhorancë. Dhe do të jetë kjo KLP që do të emërojë Proku-rorin e Përgjithshëm, ku gjasat janë të jetë i njëjti. Pra, vini re: Prokuroja e Përgjithshme zgjedh KLP-në; KLP-ja zgjedh prokuroren e përgjithshme. Gjithashtu KLP emëron të gjithë prokurorët, zgjedh SPAK-un, BKH, që do të hetojnë politikanët e korruptuar. Pra, rrezikon që i tërë sistemi të bjerë në duart e mazhorancës së sotme politike. Mendoj se ka ardhur koha që opozita, me të gjitha format politike e qytetare, ta ndalojë këtë.

# DITA E RINISË
## REAGIMET

Indeksi Kombëtar i CRCA dhe ANYN/ Buxheti për rininë është pothuajse zero

# Raporti dyvjeçar: 30% e të rinjve shqiptarë janë të papunë

## *Pulaha: Nuk ka mbështetje nga qeveria për punësimin*




Voltiza Duro

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, është publikuar Indeksi Kombëtar për të rinjtë në Shqipëri sipas të cilit 70% e të rinjve në vendin tonë kërkojnë të emigrojnë në një shtet të BE-së. Ky raport, ngre shqetësimin për situatën në të cilën ndodhet të rinjtë në Shqipëri, si edhe për mos-zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë (2015-2020) nga qeveria dhe Bashkitë. Sipas indeksit, rreth 81% e organizatave rinore në vend nuk gjejnë asnjë mbështetje për politikat e punësimit te qeveria; 80% e të rinjve nuk gjejnë asnjë shërbim miqësor në vendin tonë, ndërsa buxheti që shkon për rininë është pothuaj zero. "Mungesa e Programit Buxhetor për të Rinjtë në buxhetin e përgjithshëm të Ministrisë, jo vetëm që ndikoi në mospërmbushje të indikatorëve të matjes së zbatimit, por për më tepër, i rriti mundësitë që Plani Kombëtar të mos zbatohej. Ende nuk është krijuar asnjë grup ndër-ministror për monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit, ndërsa mungesa e stafit, shtoi paqartësinë mbi rolet e strukturave rinore dhe funksionet përkatëse të tyre",-theksohet në raportin e bërë publik nga CRCA Shqipëri dhe ANYN.

Në këtë të fundit, gjithashtu, bëhet me dije se nga mbi 50 aktivitete të parashikuara për t'u realizuar gjatë periudhës 2015-2017, vetëm 10 prej tyre janë përmbushur, si shkak i mungesave të strukturave institucionale në nivel qendror dhe lokal. Në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", përfaqësues i Rrjetit Kombëtar për të Rinjtë tregon se një ndër sfidat madhore të të rinjve në vendin tonë mbetet punësimi. "Rreth 81% e organizatave Rinore deklarohen se nuk kanë mbështetjen e qeverisë për promovimin dhe fuqizimin e programeve të nxitjes së punësimit të të rinjve. Të dhënat më të fundit nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) për vitin 2018, tregojnë se Shqipërinë zë vendin e parë në Europë për papunësinë e të rinjve. Shifrat që ofrohen nga organizatat ndërkombëtare tregojnë se rreth 30% e të rinjve shqiptarë janë të papunë. Në bazë të raportit të CRCA dhe ANYN, rreth 73% e të rinjve në vendin tonë, nuk gjejnë mbështetjen e Qeverisë në përfaqësimin e tyre në proceset vendimmarrëse dhe strukturat e qeverisjes vendore",-thekson Pulaha për "GSH". Sipas këtij të fundit, referuar raportit të rinjtë, po përdoren vetëm si një sfond politik, e nuk kanë pjesëmarrje efektive në politikë-bërje dhe vendimmarrje në të gjitha nivelet e politikës si dhe kanë një mungesë të theksuar të mbështetjes së saj.




### KËRKESAT E ORGANIZATAVE

**1.** Miratimin e Rezolutës për të Rinjtë dhe krijimin e Nën-Komisionit Parlamentar për të Rinjtë në Kuvendin e Shqipërisë;

**2.** Ngritjen e një Drejtorie për Rininë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të aftë për të zbatuar Planin Kombëtar të Veprimit në Shqipëri.

**3.** Qeveria shqiptare të miratojë një zë specifik për Rininë, në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe ai të zërë rreth 10% të fondeve të të gjithë ministrisë;

**4.** Në çdo Bashki të vendit, të krijohen Seksionet e Rinisë, ndërkohë që Këshillat Bashkiakë duhet të miratojnë një zë specifik buxhetor për të financuar programet dhe nismat rinore të organizatave dhe grupimeve rinore;

*Prej më se dy vitesh CRCA dhe ANYN po punojnë për hartimin e një ligji për Rininë, si një mjet që do të adresonte dhe rregullonte të gjitha prioritetet dhe çështjet kyçe për të rinjtë.

-Shqipëria është një ndër vendet e fundit në rajon që ende nuk e ka një Ligj për Rininë

### 30%

**TË RINJ TË PAPUNË**

"Të dhënat më të fundit nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) për vitin 2018, tregojnë se Shqipëria zë vendin e parë në Europë për papunësinë e të rinjve. Shifrat që ofrohen nga organizatat ndërkombëtare tregojnë se rreth 30% e të rinjve shqiptarë janë të papunë",-thekson Pulaha për "GSH".

### 81%

**ORGANIZATA RINORE**

"Rreth 81% e organizatave Rinore deklarohen se nuk kanë mbështetjen e qeverisë për promovimin dhe fuqizimin e programeve të nxitjes së punësimit të të rinjve. Të dhënat më të fundit nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) për vitin 2018, tregojnë se Shqipëria zë vendin e parë në Europë për papunësinë e të rinjve.

## Zv ministri i Arsimit përgënjeshtron raportin e organizatave të rinisë

Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, zv. ministri i Arsimit, Sportit e Rinisë, Shpati Kolgega tha se shifrat e publikuara nga organizatat rinore (ku thuhet se 70% e të rinjve dëshirojnë të lënë Shqipërinë) janë të rreme e të pabazuara në studime të vërteta. "Janë disa individë që për interesa financiare dhe politike shpërndajnë studime false, që të krijojnë psikozën e një gjendjeje alarmante. Fatkeqësisht ky lajm është shpërndarë si i vërtetë, po dua t'ju them se është një 'fake news' i kohëve moderne. Në këto kushte, si e justifikojmë faktin që sot në Shqipëri jetojnë, punojnë dhe studiojnë rreth 25 mijë të rinj italianë?",-u shpreh Kolgega. Më tej ky i fundit tha se nuk mungojnë sfidat për të rinjtë në Shqipëri, ashtu sikurse në çdo vend tjetër, por qasja e instancave përkatëse ndaj problematikave të të rinjve është e fokusuar dhe tejet aktive.



Zv.ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zgjodhi Korçën, si destinacionin e parë të nisjes së konsultimeve publike për projektligjin e rinisë. Ai tha se kjo është një iniciativë e qeverisë shqiptare me qëllim fuqizimin e të rinjve dhe shtimin e mundësive reale për ta. Gjatë bisedës, Kolgega u ndal në prezantimin përmbajtësor të draftit, ku përfshihen çështje të ndjeshme, si: financimi i projekteve rinore, njohja e profesionit të punonjësit rinor, ngritja e drejtorive përkatëse, dhe Planeve Lokale të Veprimit në çdo bashki të vendit, etj. "Synojmë pjesëmarrje të gjerë të të rinjve shqiptarë përgjatë këtij procesi, sepse ky projektligj do të ketë rëndësi madhore në jetën e secilit prej jush",-theksoi Kolgega.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra permbarimore "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë **06 shtator 2018** nga **ora.08.00-ora.16.00** tek kjo zyrë përmbarimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandi i I-rë, për shitjen e a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol 52, fq 1, ZK 8603, me cmim fillestar **4725000 lek**; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, me çmim fillestar **35938000 lek.**

Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN " shpk (NUIS J97201218L)

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: **052226000** ose cel: **0692075 644**

**Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :**

*Truall+Ndertese e rregjistruar ne rregjistrimin hipotekore me nr pasurie 9/268 ne ZK nr 8592, me nr prone 47 , me siperfaqe totale 161 m$^2$ , nga kjo 66 m$^2$ ndertese me adrese l partizani ne Shkoder*

*2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren* ***2,016,000 ( Dymilione e gjashtembedhjetemije ) Lekë.***

*Shitja e pasurise do te behet ( zhvillohet ) me date* ***15.08.2018*** *ora* ***16:16*** *ne Zyren e permbaruesit gjyqesore* ***Genti Bushati*** *me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.*

**SHPALLJE ANKANDI**
**Datë 17.08.2018, Ora 16:00**

**Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.**
**Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Agron Shefqet Burhani dhe dorëzanëses Hatixhe Shefqet Burhani:**
*"Apartament banimi + Truall" me sipërfaqe 62 m2, nr.i pasurisë 14/301, zona kadastrale 3574, e regjistruar në regjistrin hipotekor numër 2561 datë 07.10.1994, adresa: Lagja "15 Shtatori", pallati 53, shkalla 1, apartamenti 4, Tepelenë.*
Çmimi fillestar i ankandit të parë është në shumën ***1 280 000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.***
*Ankandi do t¸ zhvillohet n¸ ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.*




PD: Shqipëria e para në rajon për papunësinë tek të rinjtë, do të ulim tarifat universitare

# Basha: Të rinjtë shqiptarë të papunë, qeveria i ka braktisur

## "Tarifa më të ulëta dhe stazh pune të paguar"

Valentina Madani

Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, Partia Demokratike rikonfirmon mbështetjen për rininë. Është ky mesazhi që kryetari i opozitës, Lulzim Basha, përcolli dje në rrjetet sociale nga ku premtoi se me rikthimin e tyre në pushtet, do të ulin tarifat universitare dhe do të ketë stazh vjetor pune me pagesë për studentët. Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha publikoi një tabelë që, sipas tij, pasqyron braktisjen e rinisë nga qeveria Rama. Z.Basha rikonfirmoi mbështetjen e PD-së për rininë, duke premtuar se do të ulë tarifat e universiteteve dhe do të ofrojë stazh pune me pagesë për studentët, kur të vijë në pushtet. Gjithashtu, kreu i opozitës nuk ngurroi të akuzojë qeverinë Rama se ka braktisur rininë e vendit, duke mos shpenzuar asnjë lekë për këtë kategori të popullsisë. "Shqipëria zë vendin e parë në Europë, për papunësinë e rinisë, me rreth 300 mijë të rinj të papunë, ndërsa 133 mijë kanë braktisur shkollën në këto katër vite", shprehet kreu i PD-së. 80 % e të rinjve në Shqipëri nuk gjejnë asnjë shërbim miqësor në vend. Ndërsa 30% e këtij grupmoshe është e papunë. Të dhënat vijnë nga "Rrjeti Kombëtar Shqiptar" në ditën ndërkombëtare për të rinjtë. Përfaqësuesit e organizatave rinore i kërkojnë qeverisë dhe bashkive më tepër vëmendje ndaj këtij grupmoshe. Rreth 30 % e të rinjve në vendin tonë nuk kanë një punë. Të dhënat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës e rendisin Shqipërinë të parën në Europë sa i përket papunësisë tek të rinjtë. Në ditën botërore të rinisë, "Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë" dhe "Qendra për të Drejtat e Fëmijëve" i kërkojnë qeverisë të miratojë në buxhet një zë specifik për rininë, ndërsa bashkive të krijojnë seksionet për këtë grupmoshë. Kërkesa e tyre vjen pasi mbi 15 organizatat të shoqërisë civile, për gati dy vjet vlerësuan punën e bërë për zbatimin e planit kombëtar të veprimit për rininë në Shqipëri 2015-2020. ABC Neës raporton se rezultatet i përmblodhën në një raport kombëtar, sipas të cilit buxheti që shkon për rininë është thuajse zero. Nga mbi 50 aktivitete të parashikuara për t'u realizuar, përgjatë dy viteve u përmbushën vetëm 10 prej tyre. Si shkak evidentohet mungesa e strukturave institucionale në nivel qendror dhe lokal. Ndërkohë që të dhënat e Indeksit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri, që shoqërojnë këtë raport, janë një kambanë alarmi për të gjithë politikëbërësit në Shqipëri. Rreth 81% e organizatave rinore në vend nuk gjejnë asnjë mbështetje për politikat e punësimit te qeveria. Ndërsa 80 % e të rinjve nuk gjejnë asnjë shërbim miqësor në vendin tonë. Plani i miratuar në maj të vitit 2015 nga qeveria shqiptare kishte për qëllim zhvillimin dhe koordinimin e politikave rinore në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë, si dhe forcimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore e në proceset vendimmarrëse. Sipas Rrjetit Kombëtar për të Rinjtë, rinia shqiptare nuk e ka gjetur mbështetjen e premtuar nga qeveria dhe bashkitë. Të rinjve gjithnjë e më shumë po i kufizohen mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe në politikëbërje. Ndërkohë që duke u përdorur vetëm si sfond politik, të rinjtë nuk mund të arrijnë të ndryshojnë apo përmirësojnë jetën e tyre.




**SHPENZIMET**
Z.Basha akuzoi qeverinë Rama se ka braktisur rininë e vendit, duke mos shpenzuar asnjë lekë për këtë kategori të popullsisë. "Shqipëria zë vendin e parë në Europë, për papunësinë e rinisë, me rreth 300 mijë të rinj të papunë, ndërsa 133 mijë kanë braktisur shkollën në këto katër vite",-shprehet kreu i PD-së.

**EMIGRIMI**
Sipas Bashës, 300 mijë të rinj janë të papunë, 133 mijë kanë braktisur shkollat, 0 lekë mbështetje financiare për të rinjtë, 70% e të cilëve largohen në vendet e BE për një mundësi më të mirë. Postimin e tij në Twitter, Basha e shoqëron me premtimin se kur të vijë në pushtet, do të ulë tarifat universitare dhe do të ofrojë stazh vjetor pune me pagesë për studentët.

"Narkopolicia e Elbasanit mbron kriminelët"

# Berisha zbulon emrin e atij që mbron bandën e trafikantëve në Elbasan



Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një denoncim të ardhur në adresën e tij, për bandën e trafikantëve të Elbasanit. Sipas denoncuesit, këtë bandë e mbron Qazim Sejdini, që urdhëron policinë. "Narkopolicia e Elbasanit mbron bandën e trafikantëve! Dua të denoncoj fshehjen nga policia e Elbasanit në ndikimin e don Kryetarit të Bashkisë 'Sejdini". Ndalimi dhe shoqërimi i kësaj bande që merret me prostitucion, trafik droge, plagosje vrasje. Në drejtimin e don Sejdini tenderat e bashkisë dhe në të gjitha drejtoritë e juridiksionit e bashkisë së Elbasanit. Arben Trasha i dënuar në Itali për prostitucion trafik droge. Kamer (Agron) Mehja i dënuar për organizata kriminale, prostitucion, trafik droge 25 vjet. Elton Dedja i dënuar për prostitucion e trafik droge. Arjan Petova i dënuar në Itali prostitucion trafik droge. Dhe aktualisht në bar bufe shitet drogë, kokainë e heroinë. Cim Ajazi për trafik të lëndëve narkotike, heroinë. Alban Tafa drejtor në KESH i dënuar për prostitucion trafik droge në Itali", thuhet në denoncimin drejtuar z.Berisha. Më tej denoncuesi shkruan: "Doktor, Elbasani është fuçi baruti në drejtimin e Qazim Sejdinit me bandat e tij. Në ndikimin e pushtetit kërcënon drejtues institucionesh, gazetarë, punonjës policie e çdo kënd që i prek interesat apo flet të vërtetat për 100 jetë njerëzish që ndërrojnë jetë si pasojë e ndotjes ambientale, që merr ryshfete në këmbim të heshtjes dhe mos mbylljes së fabrikave".

**DENONCIMI**
"Elbasani është fuçi baruti në drejtimin e Qazim Sejdinit me bandat e tij. Në ndikimin e pushtetit kërcënon drejtues institucionesh, gazetarë, punonjës policie e çdo kënd që i prek interesat apo flet të vërtetat",-thuhet në denoncimin në adresë të z.Berisha.



## PD, Shehu: Më e mira për qeverinë Rama, të mos ndërhyjë në shëndetësi

Deputeti i PD-së Tritan Shehu, njoftoi dje se gjatë një takimi që ka pasur me disa kolegë të sistemit shëndetësor, njëri prej tyre i ka pohuar se është mirë "që qeveria gjënë më të mirë që mund të bëjë për shëndetësinë, është të mos bëjë asgjë". "Çdo herë që do të tentojë të "fusë duart", aq herë veçse përkeqëson më tej gjendjen". P.sh. dy VKM-të e fundit, në një hark të shkurtër kohor këto, veçse shkatërrojnë me tej sistemin: Vendimi për krijimin e "Operatorit shëndetësor" në rang kombëtar, do të çojë në paralizë të plotë të sistemit nëpërmjet centralizmit ekstrem që krijon në sistemin spitalor e parësor, zhvlerësimit të plotë të sistemit tonë sigurativ shëndetësor, politizimit ekstrem të institucioneve shëndetësore, zgjerimit pa kufi të hapësirave korruptive, qoftë nëpërmjet shumëfishimit të PPP, qoftë prej procedurave e politikave operative të parashikuara, etj. 2- Vendimi i qeverisë për heqjen e kritereve teknike e profesionale (Aneksi 1), për përzgjedhjen e shefave te Shërbimeve Mjekësore Universitare, ul "stekën" përdhe duke shumëfishuar kështu kushtet për lulëzimin e mediokritetit, emërimeve krejt klienteliste e politike, korrupsionit në emërime etj., gjë që jo vetëm zhvlerëson dijet, shkencën, kontributet, përpjekjet për të arritur nivele të larta, por shkatërron edhe vetë këto shërbimet, si dhe dëmton rëndë sistemin tonë në tërësi", shprehet z.Shehu. Sipas tij një goditje të rende merr nga kjo VKM veçanërisht Universiteti Mjekësor, spitalet universitare, ku po konsolidohet për çdo ditë filozofia Lei Fen-iste.

Mijëra qytetarë e miliona birra "Korça" të shitura, bilanci i "check in Korça"

# Mbyllet me sukses të madh nata finale e festës së birrës "Korça"

## "Elita 5" qershia mbi tortë e koncertit, ja si shkoi mbrëmja magjike






Me mijëra qytetarë të ardhur nga të gjitha trevat kanë shijuar deri në orët e vona ditën e djeshme në qytetin e Korçës, natën finale të festës së kthyer tashmë në traditë, atë të birrës "Korça". Nën një atmosferë festive, ushqim tradicional dhe shijen e birrës më të mirë në treg, festës iu bashkuan edhe tingujt e muzikës live, të grupit Elita 5 dhe këngëtarit Vedat Ademi. Nata finale e eventit më madhështor të verës nisi në orën 21:00 për të vazhduar deri në orët e para të mëngjesit. Në këtë vit që përkon me 90-vjetorin e birrës Korça, festës i ishin bashkuar për pesë net me radhë edhe turist të huaj, një pjesë e të cilëve kishin qenë të pranishëm edhe në vitet e mëparshme. Ata thanë se jehona e këtij eventi si dhe shija e mrekullueshme që ka birra Korça ka kaluar prej vitesh kufijtë e Shqipërisë. "Jam shumë i emocionuar që jam pjesë e këtij eventi për të tretin vit radhazi. Birra "Korça" është birra ime e preferuar shqiptare. Kam ardhur para një jave dhe qëndrova deri në fund. Nëse dikush më pyet për birrën time të preferuar ajo është birra "Korça", padyshim do t'ua sugjeroja të gjithëve, më pëlqen shumë!", thotë një turist gjerman, i cili është rikthyer për të qenë pjesë e atmosferës festive për të tretin vit radhazi. Mbrëmja finale ishte e mbushur me surpriza duke krijuar një atmosferë që të fton drejt jetës së qejfit dhe argëtimit. Për orë të tëra mijëra pjesëmarrës nën ritmet e muzikës live të Elita 5 dhe Vedat Ademit dhe shijes së freskët të birrës së parë shqiptare, birra "Korça", kënduan njëzëri këngët më të bukura shqiptare dhe jo vetëm. Për 5 net radhazi birra "Korça" vendosi 13 stenda që ofronin birrë të freskët dhe të shijshme "Korça". Ç'mund të duash më shumë në këto ditë vere për të kaluar mbrëmje të këndshme?! Kujtojmë se është bërë tashmë traditë që çdo vit në sezonin e verës, "Birra Korça" organizon festën e birrës në qytetin e Korçës. Pjesëmarrja nga të gjitha trevat në këtë festë e kthen qytetin në festival të vërtetë birre, ku kurorën e mban vetëm birra "Korça".

Pa frikë ky mund të cilësohet eventi më madhështor shqiptar i sezonit veror, jehona e të cilit rritet çdo vit.

Njëri prej tyre shfaq probleme shëndetësore, shtrohet në spital

## Ndalohen 23 emigrantë në Devoll, vinin nga Iraku, Siria dhe Palestina

**DEVOLL** - Vijon fluksi i emigrantëve nga vendet e Lindjes së Mesme. Ditën e djeshme 23 emigrantë të jashtëligjshëm janë ndaluar në zonën e Devollit. Policia kufitare njofton se emigrantët e ndaluar gjatë mëngjesit të së dielës janë të kombësive siriane, irakiane dhe palestineze. Një pjesë e tyre u kapën në fshatin Trestenik si dhe një pjesë tjetër në qendër të Bilishtit. Mes emigrantëve ka gra dhe fëmijë të vegjël. Ata janë transportuar drejt qendrës së azilkërkuesve në Tiranë. Njëri prej tyre, mësohet se ka përfunduar në spital, pasi ka shfaqur probleme shëndetësore. Ai është dërguar nga efektivët e policisë kufitare në spitalin e Korçës, për ndihmë mjekësore. Sipas mjekëve të spitalit, emigranti vuante nga diabeti dhe ka pësuar krizë diabetike për shkak të lodhjes. Pas trajtimit gjendja e tij është stabilizuar, konfirmojnë bluzat e bardha. Ndërkohë policia kufitare ka shtuar kontrollet përgjatë vijës kufitare me Greqinë, prej nga emigrantet hyjnë në brendësi të fshatrave të Devollit. Më herët zv. ministrja e Brendshme e Shqipërisë, Rovena Voda tha se nuk ka kërkesë zyrtare për krijimin e një kampi refugjatësh, por vetëm Qendra e Azilkërkuesve në Tiranë, ku paraqiten ata që kërkojnë azil në Shqipëri.



**23**

**EMIGRANTË**

Ditën e djeshme 23 emigrantë të jashtëligjshëm janë ndaluar në zonën e Devollit. Policia kufitare njofton se emigrantët e ndaluar gjatë mëngjesit të së dielës janë të kombësive siriane, irakiane dhe palestineze. Një pjesë e tyre u kapën në fshatin Trestenik si dhe një pjesë tjetër në qendër të Bilishtit.

SHKURT

### Cilësohej si person i rrezikshëm, arrestohet 38-vjeçari nga Tepelena

**SARANDE-** Një 38-vjeçar nga Tepelena, i cilësuar si person me rrezikshmëri, ka rënë në prangat e policisë gjatë një operacioni të policisë së Sarandës. Sipas uniformave blu, në pranga është vënë shtetasi me inicialet B. I, banues në Vasjar të Tepelenës.

Fillimisht ai është ndaluar në një nga klubet e natës në lagjen numër 1 të qytetit të Sarandës, ku i janë gjetur dhe sekuestruar 3 gramë lëndë narkotike e llojit "cannabis sativa". Më pas, policia ka kryer kontroll edhe në banesën ku ai jetonte, dhe në garazhin e mjetit në afërsi të Kanalit të Cukës. Në këtë të fundit, policia gjatë kontrollit ka gjetur dhe sekuestruar një armë zjarri pistoletë.

### U denoncua e humbur në Pogradec, kthehet pranë familjes 12-vjeçarja gjermane

**POGRADEC-** Adoleshentja gjermane, e cila prej tre ditësh u denoncua e zhdukur nga njerku i saj, është rikthyer ditën e djeshme pranë familjes. Policia e Pogradecit u vu në lëvizje për gjetjen e 12-vjeçares gjermane Florentina Meyer, pas denoncimit të njerkut të saj 37-vjeçar. "Më datë 12.08.2018, në Komisariatin e Policisë Pogradec, është paraqitur shtetasi V.F, 37 vjeç, banues në Pogradec, i cili ka bërë kallëzim se më datë 11.08.2018, rreth orës 15:00, në lagjen nr 1 Pogradec, në zonën e plazhit publik, ku familja e tij po pushonte i është larguar vajza e bashkëshortes së tij shtetasja Florentina Meyer, 12 vjeçe, banuese në Gjermani", shkruante policia një ditë më parë. Ndërkaq, vajza po merret në pyetje për sqarimin e ngjarjes.



### Vendi i preferuar për pushuesit shqiptarë e të huaj

## "Prestige Resort", destinacioni fantastik për pushimet

Nëse dëshironi të kaloni pushime të paharrueshme në oazin e qetësisë, shërbimeve cilësore dhe mundësive për të zgjedhur atë çfarë keni dëshirë të bëni, "Prestige Resort" është destinacioni i vetëm për këto ditë të nxehta. Edhe këtë fundjavë "Prestige Resort" mbetet më i frekuentuari. Pushues nga Shqipëria, por jo vetëm, gjejnë pushimet e kërkuara në resortin e veçantë, i cili gjendet në zemër të Golemit. Kushtet komode për të gjithë moshat, higjiena si askund tjetër, por dhe freskia që të ofrohet aty në këto ditë të nxehta vere, e kanë kthyer "Prestige Resort" në destinacionin e shumë pushuesve nga të katër anët e Shqipërisë dhe jo vetëm. "U surprizuam. Është hera e parë që vijmë me thënë të drejtën. Është shumë mirë këtu, gjithçka. Pishinat për fëmijët, uji i pastër, është i distiluar. Ambienti përreth është shumë relaksues. Shërbimi është shumë i mirë", tha një prej pushuesve të këtij resort fantastik. I cilësuar nga vetë pushuesit si vendi ideal ku mund të kalosh pushimet në bregdetin e Adriatikut, "Prestige Resort" ofron relaksin e ndërthurur me natyrën e gjelbër, që karakterizon vendin tuaj të pushimeve.

### Sizmiologët: Priten lëkundje të tjera. Emergjencat Civile shpërndajnë ndihmat

# Tërmeti i fuqishëm dëmton 215 banesa, 7 të pabanueshme

## *Haki Çako inspekton nga afër zonat e prekura*

Tërmeti i fortë i dy ditëve më parë me epiqendër në fshatin Macukull të Dibrës ka shkaktuar dëme në plot 215 banesa. Ditën e djeshme, Drejtori i Emergjencave Civile, Haki Çako inspektoi nga afër dëmet e shkaktuara dhe në një prononcim për median bëri dhe një bilanc të banesave të dëmtuara. "Janë porositur banorët, janë marrë të gjitha masat për t'i sistemuar me çadra kampingu këto familje. Deri tani janë 215 banesa të dëmtuara në bashkinë Mat, Bulqizë, Klos dhe Mirditë. Dëmet më të mëdha janë në Mat ku 7 banesa janë tërësisht të pabanueshme. Ka dëmtime të konsiderueshme në banesa",-theksoi Çako. Më tej ky i fundit bëri me dije se janë ngritur grupet e konstatimit, përkatësisht në bashkinë Mat janë 8 grupe, në bashkinë Klos, Mirditë dhe Bulqizë janë ngritur nga 4 grupe. Respektivisht në Mat janë 90 banesa të dëmtuara pjesërisht, ndërsa 4 banesa rezultojnë plotësisht të pabanueshme pas tërmetit. Ndërkohë në Bulqizë janë dëmtuar 47 banesa, në Klos 36 banesa dhe në Mirditë janë dëmtuar 38 banesa. Drejtori i Emergjencave Civile nënvizoi se janë angazhuar të gjitha strukturat për t'i ardhur në ndihmë banorëve të prekur nga tërmeti, ndërkohë që ekspertët ndodhen prej dy ditësh në terren në ndihmë të përfaqësuesve të pushtetit lokal. Ndërkohë Haki Çako, ju ka bërë thirrje të gjithë banorëve të banesave të shpallura si të pabanueshme që të largohen prej tyre, pasi në rast të përsëritjes së lëkundjeve pasojat mund të jenë fatale. Në zonat e prekura nga lëkundjet sizmike filloi konstatimi i dëmeve ndërsa Emergjencat Civile bënë shpërndarjen e ndihmave të para me çadra për familjarët e banesave të shpallura si të pabanueshme. Tërmeti i fuqishëm ka tronditur Shqipërinë rreth orës 5 e 35 minuta të ditës së shtunë. Sipas raportimeve, tërmeti ishte me magnitudë 5.1 ballë i shkallës Rihter. Lëkundjet janë ndjerë dhe në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi e Bosnjë. Epiqendra ishte 38 km nga verilindja e Tiranës e 10 km në lindje të Burrelit. Lëkundja e tërmetit është regjistruar në thellësi 10 km. Ky tërmet i bashkohet një sërë lëkundjesh që kanë "shkundur" vendin javët e fundit.

**215**
**BANESA TË DËMTUARA**
Deri tani janë 215 banesa të dëmtuara në bashkinë Mat, Bulqizë, Klos dhe Mirditë. Dëmet më të mëdha janë në Mat ku 7 banesa janë tërësisht të pabanueshme. Ka dëmtime të konsiderueshme në banesa",-theksoi Çako.



Dëmet nga tërmeti i së shtunës



Drejtori i Emergjencave Civile Haki Çako gjatë inspektimit

### PARASHIKIMET NË VAZHDIM

Plot 932 lëkundje tërmeti janë regjistruar për një muaj në vendin tonë. I fundit ishte mjaft i fortë, i regjistruar pikërisht ditën e sotme me magnitudë 5.1 ballë të shkallës rihter me epiqendër pranë Bulqizës. Sipas sizmologëve ai është i ngjashëm me atë të vitit 2017, në po të njëjtën shtrirje. "Epiqendra është në veri të Bulqizës, magnituda është 5.1, paksa më e ulët se ajo e 4 korrikut, por ndjeshmëria gjithmonë favorizohet nga kushtet tektonike të tërmetit, pra nga thyerja tipike që gjeneron tërmeti. Tërmeti është ndjerë fort lokalisht për shkak të thellësisë, ka pasur një thellësi prej 23 km dhe kjo ka bërë që tërmeti të ndjehet gjerësisht, edhe jashtë kufirit si në Maqedoni dhe Mal të zi, sipas të dhënave që disponojmë paraprakisht", është shprehur Edmond Dushi, sizmiologu i Institutit të Gjeoshkencave për TCH. Sipas lëkundjet sizmike do të vazhdojnë.

### Merr jetë projekti "Fund mësimit me dy turne"

## Rikonstruksion në shkollat e kryeqytetit, kushte më të mira për mijëra nxënës

**SHKOLLAT E REJA**
Krahas hapjes së shkollave të reja këtë vit, edhe ato ekzistuese pritet që t'i mirëpresin fëmijët e kryeqytetit me kushte shumë herë më të mira e komode.

Ka nisur rikonstruksioni pothuajse në të gjitha shkollat e kryeqytetit për të ofruar kështu kushte më të mira për nxënësit që do fillojnë vitin e ri mësimor në shtator. Bashkia e Tiranës, ashtu si ka deklaruar edhe më parë po punon intensivisht me institucionet arsimore të parauniversitarit që do të hapin dyert për mijëra fëmijë. Krahas hapjes së shkollave të reja këtë vit, edhe ato ekzistuese pritet që t'i mirëpresin fëmijët e kryeqytetit me kushte shumë herë më të mira e komode. Kështu në shkollën "Partizani" është bërë lyerja e godinës dhe riparimet e brendshme, ndërsa edhe në shkollën "Myslym Keta" po punohet me intensitet duke riparuar dyert, sistemin elektrik, si dhe sistemin e tualeteve. Riparimeve këto kohë i janë nënshtruar edhe shkolla "28 Nëntori", si dhe "Kongresi i Lushnjës", ku krahas riparimit të fasadës dhe ambienteve të brendshme, është rregulluar edhe tarraca. Vlen të theksohet se në kryeqytet ka marrë jetë projekti për ndërtimin e shkollave të reja, i cili do t'i japë zgjidhje përfundimtare mësimit me dy turne. Standardet për planifikimin e shkollave të reja kanë marrë parasysh numrin e shkollave në bazë të popullsisë, rrezen e mbulimit, si dhe numrin e nxënësve për klasë.



Life pages
GAZETA SHQIPTARE
Suplement
E hënë 13 Gusht 2018 REDAKTOR: VOLTIZA DURO

## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja: Rrugët alternative për të kuruar menisqet e dëmtuara

## KESHILLA



Rëndësia e ushqimeve proteinike në dietën ushqimore

# Dr. Tritan Kalo:



Mjeku infeksionist tropikalist dhe reanimator: Këshilla për t'u mbrojtur nga infektimi

# Rreziqet për shëndetin tonë që lidhen me përdorimin e ushqimeve

"Kujdes me mishin, qumështin dhe akulloret"

**Mjeku infeksionist tropikalist dhe reanimator:** Këshilla për t'u mbrojtur nga infektimi

# Dr. Tritan Kalo:


Dr. Tritan Kalo

## Rreziqet për shëndetin tonë që lidhen me përdorimin e ushqimeve

### *"Kujdes me mishin, qumështin dhe akulloret"*

Voltiza Duro

*Jemi ende në stinën e verës dhe në këtë kohë kur temperaturat e larta kanë pushtuar vendin, konsumatorët duhet të tregojnë një kujdes tejet të veçantë me ushqimet që përdorin. Në një intervistë ekskluzive për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", Dr. Tritan Kalo, mjek infeksionist, tropikalist dhe reaminator tregon se cilat janë kategoritë më të predispozuara për t'u prekur nga infeksionet, viruset, bakteret apo dhe toksinat e tyre. Më tej dr. Kalo i bën thirrje qytetarëve që të kenë kujdes me disa produkte si mishi, qumështi, akullorja apo dhe ushqimet fast food.*

**Sa të predispozuar jemi për t'u prekur nga infeksionet të cilat lidhen me përdorimin e ushqimeve të ndryshme në stinën e verës dhe jo vetëm?**

Si konsumatorë të produkteve të ndryshme ushqimore, por edhe i ujit më shumë se në çdo stinë të vitit, të gjithë mundet të përbëjmë subjekt të infektimit nga viruset, bakteret apo toksinat e tyre, si dhe parazitët e ndryshëm, të cilët mundet ti kenë infektuar këto produkte para konsumimit të tyre: që në origjinë; gjatë përgatitjeve të ushqimeve të ndryshme; gjatë ruajtjes së tyre, apo edhe gjatë shërbimit të tyre. Me një fjalë të vetme asnjëri prej nesh nuk është i mbrojtur nga këto infeksione. Higjiena e lartë individuale si dhe higjiena e lartë në përgatitjen, ruajtjen dhe shërbimit janë hallkat bazë të uljes së mundësisë së infektimit, nga konsumimi i produkteve të ndryshme ushqimore të freskëta apo të parapërgatitura.

**Cilat janë kategoritë e individëve më të prekur prej këtyre infeksioneve?**

Sikundër e theksova edhe më lart, të gjithë si konsumatorë mundet të prekemi prej këtyre infeksioneve,



POR individët e grup moshave ekstreme, fëmijët e vegjël dhe ata mbi 65 vjeç, individët që vuajnë nga sëmundje kronike, të cilat e dobësojnë reagimin e sistemit tonë imunitar si Diabeti i sheqerit, Nefropatitë kronike, Insufiçencat kardiake apo ato pulmonare, Hepatopatitë kronike, të Sëmurët me HIV/AIDS, Sëmundjet kronike të artikulacioneve dhe indeve lidhëse, që shpesh marrin në mënyrë të vazhdueshme kortikoidë, të sëmurët me sëmundje malinje nën kemioterapi apo rrezatim, etj. janë subjekte më vulnerabël dhe më të prekshëm prej tyre, e sidomos klinika e manifestimeve të këtyre infeksioneve në subjekte të tillë është edhe më e agravuar. Kujdesi që duhet të kushtojmë ndaj çdo produkti ushqimor që ne konsumojmë, e bën të mundur kalimin e kësaj stine mjaft të nxehtë dhe jo vetëm të saj, pa u shqetësuar nga infeksione të lidhura me konsumimin e këtyre produkteve.

**Nga cilat ushqime duhet të bëjmë më shumë kujdes?**

"Të hamë apo të mos hamë" - kjo është çështja. Të gjithë ne duhet të bëjmë kujdes për gjithçka që konsumojmë, përfshirë edhe ujin e pijshëm. Megjithatë janë disa produkte ushqimore më të ekspozuara ndaj ndotjes bakteriale dhe jo vetëm. Le të fillojmë me mishin. Nëse therja e bagëtive si lopët, qengjat, delet apo kecat kryhet jashtë zinxhirit të licencuar të therjes dhe kontrollit veterinar, konsumi i tij mundet të na rrezikojë nga sëmundje shumë të rënda disa dhe vdekjeprurëse si plasja (antraksi), apo parazitoza si cisticerkoza, trikineloza, gëlbaza e mëlçisë (Fasciola hepatica), etj. Derrat e rritur nëpër stoqet e mbetjeve të qyteteve bartin në trupin e tyre helme nga më të ndryshme, sidomos metale të rënda tejet dëmprurëse për organizmin tonë. Pulat e pa kontrolluara bartin jo pak salmonela, shumë të dëmshme për të gjithë, por në veçanti për fëmijët. Qumështi i kafshëve të sëmura me bruçelozë apo tuberkuloz, si dhe produktet e tyre të prodhuara nga qumështi i pa pasterizuar, rrezikojnë organizmin tonë nga sëmundje jo pak invalidizuese për të si Bruçeloza e Tuberkulozi bovin. Produktet e qumështit si akullorja mundet mjaft mirë të bëhet pre e infeksionit nga Stafilokoku, duke dhënë intoksikacione ushqimore shumë pak kohë pas konsumimit të saj. Mos ruajtja e miellit, orizit apo edhe e vetë bukës në mjedise të mbrojtura nga brejtësit (minjtë), të shumtë si në mjediset urbane edhe jashtë tyre, i bën ato të ekspozuara nga ndotja prej urinës së tyre dhe e përhapjes së leptospirozës. Orizi i gatuar jo si duhet, apo i ngrohur dhe i ringrohur disa herë mundet të kontaminohet nga Bacillus cereus, një nga mikroorganizmat më të rrezikshëm të shkaktimit të helmimeve ushqimore. Të mos harrojmë faktin se mjalti nuk duhet konsumuar në fëmijët nën dy vjeç, për shkak të mundësisë së pranisë në të Clostridium botulinum. Për rikujtesë është mikroorganizmi, i cili jep forma të rënda të intoksikimit edhe në të rriturit, me paraliza të rënda e vdekjeprurëse prej produkteve të konservuara dhe jo mirë të ambalazhuara (konservat që kanë kapatë të bombuar, kurrë nuk duhen konsumuar). Ajo që ne neglizhojmë dhe jemi pak të informuar është prania në ushqimet tona, në produktet e ndryshme bujqësore e pesticideve apo produkteve të ndryshme stimulante të prodhimit apo pjekjes së sforcuar të tyre, diçka që është denoncuar dhe vijon të denon-



Nëse ushqimet e gatuara nuk konsumohen brenda 2-3 orëve të përgatitjes së tyre, ato ose duhet të futen më mjedise ftohëse frigoriferike, ose në rast të mos pranisë së tyre të hidhen dhe të mos konsumohen. Po ashtu pas përgatitjes në pritje të shërbimit të tyre brenda këtij harku kohor, ato duhet të ruhen në mjedise të mirë-ajrosura dhe pa praninë e mizave në to. Një këshillë e tillë vlen edhe për festimet e ndryshme dhe të shumta të stinës së verës.

Qytetarët tanë duhet të vetë-ndërgjegjësohen për faktin se ushqyerja e trupit të tyre është një obligim madhor jo vetëm për mirëfunksionimin e tij, por edhe për mirëqenien shëndetësore të tij. Nuk duhet të ushqehemi kudo dhe pa kujdes për atë çka ne konsumojmë. Nuk duhet të ushqehemi pa një higjienë të mirë të duarve tona me anë të të cilave ne prekim pothuajse gjithçka që fusim në gojë.

cohet me forcë në organe të ndryshme të shtypit tonë të përditshëm. Vitet e fundit pavarësisht kontrollit të produkteve ushqimore dhe të lëndëve të para të prodhimit të tyre, kontroll që çalon kudo dhe kurdoherë, ka një shtim të çregullimeve gastro-intestinale për shkak të ushqimeve të kontaminuara me mikroorganizma të ndryshëm para apo gjatë përpunimit të tyre, si dhe gjatë ruajtjes apo shpërndarjes së tyre. Ndaj kujdes dhe vetëm kujdes për gjithçka që fusim në gojën tonë. Nuk ju informojmë për t'ju panikuar, POR thjesht për t'ju mirëndërgjegjësuar mbi gjithçka që ju konsumoni.

**Sa të sigurta janë ushqimet e fast food-eve?**

"Fast-food"- et, janë një dukuri e re në Shqipëri në raport më vendet e tjera Perëndimore, por që pak nga pak po zënë një vend jo të neglizhueshëm në të ushqyerit tonë. NËSE gjithçka që përgatitet në to i nënshtrohet rregullave higjeno-sanitare, si në ruajtjen edhe në tregtimin e tyre, nuk ka asnjë rrezik për konsumimin e produkteve që ato përgatisin. Por a ndodh gjithmonë kështu? Nëpër rrugë shëtisin ambulantë me produkte të llojit "fast-food" pa asnjë kusht në përgatitjen dhe ruajtjen e tyre. Sipas OBSH-së, 30-60% e helmimeve ushqimore vinë pikërisht prej kësaj mënyre të përgatitjes dhe tregtimit të ushqimeve. Po ashtu sa të kontrolluar janë përgatitësit e ushqimeve në këtë zinxhir të ushqyerjes së popullatës para se ata/ ato të fillojnë punë në to? A i përgjigjet realisht "Certifikata sanitare" që ata marrin nëpër DSHP-të e ndryshme gjendjes së bartshmërisë së mikroorganizmave apo parazitëve të ndryshëm prej tyre? Sa herë në vit kontrollohen cilësisht dhe jo formalisht këto mini-restorante? Sa herë pas përgatitjes së pataeve ndërrohet vaji i enëve ku ato skuqen apo çfarë lloj vaji ato përdorin në këtë proces? AKU-ja si dhe Inspektorati i Lartë Shtetëror pranë Ministrisë së Shëndetësisë, kanë jo pak punë për të kryer në këtë drejtim.

> "Të hamë apo të mos hamë" - kjo është çështja. Të gjithë ne duhet të bëjmë kujdes për gjithçka që konsumojmë, përfshirë edhe ujin e pijshëm. Megjithatë janë disa produkte ushqimore më të ekspozuara ndaj ndotjes bakteriale dhe jo vetëm. Le të fillojmë me mishin. **Nëse therja e bagëtive si lopët, qengjat, delet apo kecat kryhet jashtë zinxhirit të licencuar të therjes dhe kontrollit veterinar, konsumi i tij mundet të na rrezikojë nga sëmundje shumë të rënda disa dhe vdekjeprurëse si plasja (antraksi), apo parazitoza si cisticerkoza, trikineloza, gëlbaza e mëlçisë (Fasciola hepatica), etj.**



**Si duhet t'i ruajmë ushqimet në mënyrë që ato të mos prishen?**

Nëse ushqimet e gatuara nuk konsumohen brenda 2-3 orëve të përgatitjes së tyre, ato ose duhet të futen më mjedise ftohëse frigoriferike, ose në rast të mos pranisë së tyre të hidhen dhe të mos konsumohen. Po ashtu pas përgatitjes në pritje të shërbimit të tyre brenda këtij harku kohor, ato duhet të ruhen në mjedise të mirë-ajrosura dhe pa praninë e mizave në to. Një këshillë e tillë vlen edhe për festimet e ndryshme dhe të shumta të stinës së verës. Duhet të kemi parasysh se në rast ruajtje për disa ditë të ushqimeve në frigorifer pas përgatitje së tyre, ne nuk duhet të presim ftohjen e tyre para se ti vendosim ato në to. Të mos harrojmë edhe faktin se në rast kontaminimi të ushqimeve të përgatitura para se ato të futen në frigorifer, ruajtja e tyre në mjedise të ftohta apo edhe në ngrirje NUK i shkatërron aspak mikroorganizmat apo toksinat e tyre, përkundrazi i konservon ata edhe më mirë. Ringrohja e tyre para përdorimit të ushqimeve të para-kontaminuara, i bën po aq aktivë mikroorganizmat apo toksinat e tyre duke shkaktuar helmime ushqimore shpesh edhe me pasoja fatale për organizmin tonë. Jo të gjithë kemi frigoriferë, por ka shtëpi të pajisura me mjedise shumë të freskëta dhe në to duhet të këtë dollapë më kapakë të mirë-puthitur dhe me rrjeta teli, të cilat evitojnë kontaktin e mizave apo brejtësve me ushqimin që ne konsumojmë apo me produktet me të cilat ato përgatiten. MOS harroni faktin se higjiena në përgatitjen, ruajtjen dhe shërbimin e ushqimit të gatuar varet shumë nga higjiena personale a tyre që merren me këto procese, sidomos higjiena e duarve. Lani duart me kujdes para dhe pas çdo procesi.

**Cilat janë këshillat tuaja për qytetarët?**

Qytetarët tanë duhet të vetë-ndërgjegjësohen për faktin se ushqyerja e trupit të tyre është një obligim madhor jo vetëm për mirëfunksionimin e tij, por edhe për mirëqenien shëndetësore të tij. Nuk duhet të ushqehemi kudo dhe pa kujdes për atë çka ne konsumojmë. Nuk duhet të ushqehemi pa një higjienë të mirë të duarve tona me anë të të cilave ne prekim pothuajse gjithçka që fusim në gojë. Të ushqehemi shëndetshëm e me gjithçka sa më të freskët dhe sa më larg ushqimeve të parapërgatitura. Të bëjmë kujdes kur blejmë në "fast food-e", për të këqyrur mënyrën se si gatuhet dhe shërbehet ushqimi ynë. Edhe kur ushqehemi në ndonjë restorant "të mirë" ne duhet të vëzhgojmë me kujdes enët në të cilat na shërbehet ushqimi, niveli higjeno-sanitar i lokalit dhe i personelit, prania ose jo e mizave në to, si dhe higjiena në tualetet kolektive. Një mjedis i pastër flet vetë edhe për kujdesin që tregohet nga personeli i atyshëm, në përgatitjen e shërbimin e ushqimeve që ne do të konsumojmë.




**Mjeku popullor:** Si të shmangni ndërhyrjen kirurgjikale. Simptomat kryesore të sëmundjes

# Ylli Merja: Rrugët alternative për të kuruar menisqet e dëmtuara

## "Përbërësit bimorë të çajit çudibërës"

Voltiza Duro

Menisku është një strukturë kërcore e ndodhur mes dy kockave të këmbës, mes asaj të kërcirit (tibies) dhe kofshës ose femurit. Dallohen dy menisqe, ai medial në formën e shkronjës C që është i vendosur në pjesën e brendshme të gjurit ndërsa menisku lateral është në formën e shkronjës U dhe ndodhet në pjesën e jashtme të gjurit.

Menisqet shërbejnë si amortizatorë sepse shpërndajnë ngarkesat. Ata mbajnë 40-60% të peshës së trupit, konkretisht 2- fishin gjatë ecjes dhe gati tetëfishin gjatë vrapimit. Ndihmojnë në lubrifikimin dhe ushqimin e artikulacioneve të gjurit si dhe reduktojnë fërkimin dhe zvogëlojnë konsumin e kërcit. Kërci artikular është një material i butë, i rrëshqitshëm, që mbulon sipërfaqet fundore të kockave që formojnë artikulacionin e gjurit. Duke shpërndarë forcat që veprojnë mbi artikulacionin e gjurit, menisqet mbrojnë kërcin nga ushtrimi i shtypjes në një sipërfaqe të vogël të artikulacionit. Në mungesë të menisqeve forca vepron në një sipërfaqe të vogël të sipërfaqes artikulare, duke shkaktuar një dëmtim degjenerativ të kërcit artikular të quajtur osteoartrit. Menisqet i japin stabilitet artikulacionit të gjurit. Pa menisqet, pjesa e rrumbullakët e femurit do të rrëshqiste mbi një sipërfaqe të sheshtë dhe nuk do lejonte drejtqëndrimin.

### Shkaqet e dëmtimeve të menisqeve

Rupturat (çarjet) e menisqeve në pacientët nën 30 vjeç zakonisht ndodhin si pasojë e lëvizjeve të forta përdredhëse siç ndodhin më shpesh nga një aktivitet sportive ose nga trauma të ndryshme p.sh. te sportistët nga goditjet me takën e këpucës. Mund të vijë nga pesha e tepërt dhe një lëvizje e pakontrolluar që kompreson meniskun. Përfshihen, gjithashtu, si risk dhe këpucët me taka dhe të parehatshme. Te grupmoshat e vjetra vjen si pasojë e degjenerimit të kockave, të cilat humbasin fortësinë dhe elasticitetin që kanë pasur më para.

### Simptomat

Dhimbja është ankesa kryesore që kanë pacientet me çarje të meniskut dhe referojnë për dhimbje parciale vetëm te menisku ose dhimbje totale në gjithë gjurin. Ky i fundit mund të enjtet duke dhënë ndjesinë e ngurtësisë dhe ngushtimit. Kjo shpesh vjen si pasojë e grumbullimit të lëngut në brendësi të artikulacionit. Ndonjëherë quhet ujë në gju.

Diagnoza vendoset me MRI (rezonancë magnetike).

### Trajtimi

Trajtimi fillestar i meniskut të çarë ka për qëllim uljen e dhimbjes dhe të ënjtjes së gjurit. Pushimi, trajtimi me mjekësinë alternative dhe terapia fizike janë zgjidhjet për trajtimet e meniskut të carë. Kura më e mirë për të trajtuar meniskun e dëmtuar përfshin një shumëllojshmëri elementësh. Fillimisht pacienti duhet të bëjë lyerje të këmbës 2 herë në ditë me ekstraktin e helicrisiumit qe është antiiinflamatorë dhe eliminon edemat nëse ka. Pasi thahet vendoset vaji e sinapit që është një qetësues,zbutës dhe rigjenerues i meniskut. Në mëngjeslyejmë këmbën me ekstrakt helicrisium dhe pas 5 minutave vendosim vajin e sinapit dhe bëjmë masazh për 10-15 minuta nga kavilja drejt kofshës. Pas lyerjes mund të bëni terapinë ushtrimore për 15 minuta siç është e shpjeguar në fotot më lart.



Mjeku popullor
Ylli Merja



Pas 30 minutave mbështillni gjurin me qepë të shtypur dhe lëreni për 5-6 orë. Qepa ka vetinë të tërheqë inflamacionin dhe toksinat pasi është një antioksidant shumë efektiv. Në drekë-shpërlani gjurin nga qepa dhe vendosni xhel aloe vera dhe mbajeni 5-6 orë . Në darkë : Lyejmë këmbët me ekstraktin e helicrisiumit dhe vajin e sinapit.

Gjatë ditës: Pini 1-2 lugë çaj me vaj balsani.

### Bimët medicinale

Ky trajtim konsiston në nxitjen e organizmit për prodhimin e lëngut kockor në kufi të plasaritjes. Pra, do të përdoren bimë që nxitin qarkullimin e gjakut dhe që përmbajnë minerale si Fe, Mg, Ca etj. Me prodhimin e lëngut do të ndodh procesi i osifikimit të tij. Pra, ky xhel i trashë fillon të formojë pika kockore që me kalimin e kohës bashkohen me njëra - tjetrën dhe realizojnë ngjitjen e kockës. Bimë të tilla si: tërfili i kuq, hithra, trëndafili i egër, këputja, murrizi që përmbajnë një "lumë "të tërë me kripëra minerale. Këto bimë mund të kombinohen dhe të na japin efektin e dëshiruar. Përzierja me bimë forcon meniskun dhe strukturat përreth. Në 3 litra ujë zieni për 2 minuta: një pako çaj reumatizme, një dorë lule murrizi, një dorë hithra, një dorë këputje ,një dorë tërfil dhe pini 3x1 gotë në ditë nga ky çaj para buke.

### Frutat e thata

Rëndësi ka dhe përzierja me fruta të thata siç janë bajamet e egra dhe kajsite. Personi duhet të konsumojë dy herë në ditë nga 4 fara bajame para buke dhe dy herë nga 5 fara kajsie pas buke ose mund ti marrë në një përzierje të vetme duke përdorur 2 lugë gjelle në dite. Me kurën e përmendur më lart ju keni për të pasur rezultatet e duhura.

# Rëndësia e ushqimeve proteinike në dietën ushqimore

Voltiza Duro



Të gjithë flasin për ushqimet me proteina dhe rëndësinë që ato kanë në dietën tonë ushqimore. Këtë herë blogerja healthy lifestyle, Çenkuela Hasa do të sjellë për ju disa informacione të vlefshme se përse ushqimet proteinike janë kaq të rëndësishme për organizmin tonë dhe pse janë kaq të rëndësishme kryesisht për personat që merren me aktivitet fizik. Ato janë baza e qelizave të trupit tonë. Proteinat janë të përbëra nga njësi më të vogla të quajtura aminoacide të cilat lidhen në zinxhirë me njëra-tjetrën. Proteinat kanë funksion ndërtues në organizmin tonë, janë shumë të rëndësishme për të na mbajtur në jetë, duke ndikuar edhe në rritje. Por kur bëhet fjalë për dieta që kanë rezultate shumë pozitive në humbjen e peshës dhe ndërtimin e masës muskulore, patjetër do zbuloni se përfshirja e proteinave në të tilla dieta është e lartë.



### Pse duhet të përdorim proteina?

Nëse ju përdorni ushqime me proteina më shumë se karbohidrate do të keni mundësinë të digjni kalori më shumë. Kjo për arsyen e vetme sepse të tretësh ushqime proteinike kërkon shumë herë më shumë energji. Disa nga ushqimet klasike me proteina të larta janë veza, kryesisht e bardha e saj, fileto pule, peshku kryesisht salmoni, frutat e thata, bulmeti, brokoli, hirra e qumështit. Një funksion tjetër i proteinave është se ato ndikojnë në nxitjen e metabolizmit. Më shumë proteina do të thotë një metabolizëm më i shpejtë. Dhe një metabolizëm i shpejtë do të thotë më pak kilogramë dhe më pak dhjam.

### Shtimi i masës muskulore

Më shumë masë muskulore do të thotë që trupi juaj djeg më shumë kalori, madje edhe në gjendje qetësie. Ju mund të shijoni më shumë ushqime se dikush tjetër dhe muskujt tuaj nuk do ju lënë të shtoni peshë. Por proteinat janë elementi kryesor që do ju ndihmojë që të shtoni masë muskulore. Sidomos pas stërvitjes kur muskujt tuaj dëmtohen përdorimi i proteinave më pas me ushqime proteinike do ju ndihmojë që të rigjeneroni muskujt . Por roli i saj në shkrirjen e dhjamit është shumë i rëndësishëm edhe për faktin sepse në momentin që ju merrni mjaftueshëm proteina, trupi aktivizon prodhimin e hormonit glukagon që është përgjegjës për shkrirjen e dhjamit pasi sinjalizon trupin tonë që yndyrën e ushqimeve ta përdorë për energji. Proteinat kanë edhe shumë funksione të tjera si balancimi i sheqerit në gjak, ndihmojnë në zbutjen e urisë duke na dhënë ndjesinë e ngopjes. Prandaj për këtë edhe shumë arsye të tjera, përdorimi i tyre ka shumë rëndësi.



Sasia e përdorimit të tyre varet nga pesha, aktiviteti fizik, mosha dhe gjinia. Por për njerëzit me jetë normale dhe që nuk merren me sporte, sipas studimeve të fundit është rezultuar që sasia e proteinave të marra duhet të jetë 0.6 deri 0.9 gram të peshës trupore në ditë.



KULTURA EVROPIANE

# Një francez zbulon mitet

Nga Luan Rama

*Ekspeditat e arkeologut të shquar Leon Heuzey në Shqipërinë e 1860-ës. Perënditë e antikitetit në Orikum e Apoloni, dedikimet për Dioskurët në gjirin e Gramatës. Legjenda dhe rrëfime nga thellësia e kohërave*

Një nga mitet më të vjetra të kulturës evropiane, të kënduar nga bardët antikë (çka e bën dhe prekursorin e epikës legjendare ballkanike e evropiane), është ai i Dioskurëvë, që në greqishten e vjetër do të thotë "bij të Zeusit", bijtë binjakë të Zeusit me Leda-n, të cilët quheshin nga romakët Kastor dhe Pollux dhe që ishin mbrojtësit e marinarëve dhe shpëtimtarët e njerëzve në situata të dëshpëruara. Është interesant fakti që tempulli i Dioskurëvë nuk ndodhet vetëm në Olimp dhe as vetëm në Romë, më që romakët e huazuan këtë mit ashtu si shumë mit e të tjera greke. Ai gjendet edhe në Gramata të Shqipërisë, në një nga gjiret e vegjël midis Karaburunit dhe Himarës, i cili në kohën antike, e më pas bizantine e mesjetare, ishte kthyer në një vend pelegrinazhi. Në vitin 1861, Léon Heuzey, një arkeolog i shquar francez, bashkë më bashkëpunëtorin e tij, arkitektin Honoré Daumet, ishin nisur më mision nga perandori Napolon III, që të zbulonin vendet ku ishte ndeshur Cezari më Pompeun. Ata kishin hulumtuar në Farsale dhe Filipopolis të Maqedonisë dhe pastaj kishin zbarkuar në Shqipëri, duke zbuluar Durrësin apo Dyrrachium-in antik si dhe Apoloninë, të cilat ishin kthyer në fushëbeteja të përgjakshme midis legjionarëve romakë të të dyja kampeve. Por veç kësaj, ata iu drejtuan dhe një prej vendeve mjaft të njohura të asaj epoke, Orikumit, ku kishte zbarkuar fillimthi Cezari bashkë më "cahortat" e tij për të luftuar kundër Pompeut. Në shënimet e tij rreth këtij udhëtimi, Léon Heuzey ka shkruar: "Para udhëtimit tonë në këtë vend, hartat e Greqisë së vjetër, nuk e shënonin saktë pozicionin e qytetit të vogël të Orikumit në brigjet e gjirit të Vlorës, në Epir, pra një nga stacionet bregdetare më të famshme dhe më të fortifikuarat e Antikitetit. Në atë hartë, ajo vendosej shumë tepër në lindje, ndërkohë që ajo gjendej në jug-lindje, në pjesën më të tërhequr të gjirit, midis maleve Akrokeraune dhe lumit Kélyoinos, apo Lumit të Bardhë, siç e quajnë sot. Gjiri i futur, në radën e mbyllur të Vlorës, është vendi i vetëm që mund të ofrojë qëndrimin e mbrojtur të anijeve kundër gjithë erërave. Ky vend quhet nga banorët "Porti i Dukatit" dhe në pjesën më të thellë të tij, quhet "Pasha-Liman", në kujtim të kapitën-pashës, më që aty strehoheshin zakonisht flotilët turkë, ashtu siç në Oricum-in e vjetër qëndronin anijet romake, apo në Mesjetë, Jeriko, ku strehoheshin anijet bizantinë apo normandë. Pikërisht atje, në zbuluam në vitin 1861, gjurmët e qytetit antik dhe shënuam të dhënat e ndryshme topografikë, çka shpjegojnë emrin e tij të famshëm, gjithashtu dhe si një kantier detar... Atje, shtëpitë formonin një vazhdimësi shkallësh koncentrike, secila më rrugë në çdo rreth të tyre dhe me shkallare të shumta që ngjiteshin në të gjitha anët deri në lartësitë e akropolit. Ai vetë është i përbërë nga një mur rrethues, i ndarë më dy pjesë përmes një muri të brendshëm. Në majë ishte një kapele e rrënuar, ku dhe vetë shenjti ishte harruar, çka shënonte dhe sheshin qendror të tempullit të qytetit. Ky pozicion i krijuar nga natyra si një lloj vizatimi, i përgjigjët katërpërcipërisht, asaj ç'kemi mësuar mbi Orikumin dhe pikërisht përshkrimi shumë i saktë, dhënë nga Julius Cezar mbi këtë strehim bregdetar në brigjet e Epirit... Por nga koha e Perandorisë Romake shihen ëndë gjurmët madhështorë të "rhéteur"-it Herode Atticus, i cili e ringriti këtë qytet më shpenzimet e tij... "







Por një nga zbulimet mjaft interesante ishte dhe ai i vendit të shenjtë të Dioskurëvë, për të cilin nuk dihej asgjë dhe që vetëm një udhëtar italian, para dy shekujsh e kishte pikasur dhe kishte shënuar disa nga mbishkrimet rreth tyre. Heuzey e kishte gjetur këtë shënim dhe kureshtar për të zbuluar të vërteten rreth këtij vendi, që në Paris e kishte përcaktuar së do të shkonte dhe në Gramata. Dhe kështu do të ndodhte, pasi Dioskurët ishin një nga mitet më tërheqës, për të cilin autorët antikë kishin shkruar shumë, duke filluar më Homerin, i cili i përmend ata në veprën e tij Iliada. Dihej, gjithashtu, se këta dy luftëtarë të jashtëzakonshëm, kishin vdekur para Luftës së Trojës, por megjithatë, epika e kënduar thoshte së edhe pse në botën tjetër, ata ishin të gjallë dhe Zeusi i mbulonte më ndere e lavde.

Më që nga ana e tokës, vendi ishte mjaft i vështirë për të zbarkuar dhe duhej shkuar më një barkë nga ana e detit, Heuzey vendosi të dërgonte bashkëpunëtorin e tij më të ri, Daumet. "Pjesa më e egër e maleve Akrokeraune, - vazhdon në shënimet e tij Heuzey, - na bëri të mundur të shohim mbishkrime të shumta. I kisha kërkuar zotit Daumet të shkonte në anën e pasmë të maleve që binin mbi det, në gjirin e vogël të Grammata-s, atje ku Ciriako i Ankonës kishte kopjuar tashmë në greqisht dhe latinisht disa dedikime për nder të Dioskurëvë. Më ndihmën e një varkë, z. Daumet preku gjirin e vogël në një të futur ku kishte rërë, rrethuar aty nga shkëmbinj, vend i cili, nga ana malorë iu duk pa dalje. Por ajo çarje shkëmbore ofronte një vend të mrekullueshëm shpëtimi në rast stuhie kundër shkëmbinjve që binin thikë mbi det. Atje, në dy vende të faqeve shkëmborë, kishte mbi njëmijë mbishkrime që në greqisht justifikonin emrin "εις Γραμματα" dhe që na kujtojnë emrat e vizitorëve të shumtë që rastësia e udhëtimit në det i kishte sjellë në këtë vend të shkretuar. Atje ata janë zbavitur dhe kanë shkruar mbi shkëmb, duke dëshmuar ndjenjat e tyre fetare, në këtë strehë të krijuar si mrekullisht kundër rreziqeve më të mëdha... Por mjerisht, koha i kishte fshirë mbishkrimet mbi shkëmb, duke e bërë leximin e tyre pothuaj të pamundur. Ato mbishkrime të rralla që kopjoi, Daumet mendoi së vetëm ato mund të shënonte lehtësisht dhe që i përkisnin periudhave të ndryshme. Mbishkrimet e Ciriakos (Cyriaquë), janë "proscynèmës", pra për ndër të Dioskurëvë, zotërvë-shpëtues, mbrojtësve të anijeve dhe të marinarëve. Por udhëtarët, në evokimet e tyre në këto mbishkrime, nuk mendonin vetëm për veten: shpesh, përpara hyjnive, ata luteshin në emër të një apo disa familjarëve të tyre, apo njerëzve që i kishin ngarkuar të bënin për ta atë akt përkushtimi fetar, duke shkruar e gërvishtur mbi gur emrin e tyre... Duket së vendi i Dioskurëvë të maleve Akrokëraunë, "Dioscoureion", nuk kishte vetëm vizitat e rastësishme të marinarëve në fatkeqësi, por ai ishte kthyer në një vend të vërtetë pelegrinazhi. Zoti Daumet ka parë një faqe shkëmbore dhe një gurore ku nxirreshin gurë, të ngjashëm më ato të gjetura në shumë nga antikitetet e Dyrrachium dhe ➔




të Apollonisë. Vështirësia e transportimit nga toka, përmes maleve të Epirit, bëri që banorët t'i gjenin e merrnin më mirë gurët në faqet shkëmborë anës detit. Më pas, unë pikasa atë çka kisha vënë re në gurët e Filipopolit në Maqedoni. Përkushtimi kristian i kishte zëvendësuar këto formula e simbole si dhe përkushtimet e paganëve. Një numër i madh mbishkrimesh mbanin tashmë kryqe dhe pikërisht në të njëjtën faqe shkëmbore, ku ishin bërë mbishkrimet për Dioskurët. Ata luteshin për ndihmën e Zotit. Një mbishkrim i datës 1367, tregonte në greqisht emrin e perandorit Jan Paleologut I, i cili mbretëroi nga viti 1356 deri në vitin 1391. Viti 1367 është pikërisht viti kur ai ndërmori udhëtimin detar drejt Venedikut e Italisë më shpresën e kotë që edhe pse pranonte nga halli të konvertohej në katolik, ta bënte Papën Urban V që ta ndihmonte në mbrojtjen e perandorisë së tij që po pushtohej tashmë nga turqit. Sigurisht, ai mund të këtë kaluar këndej dhe ndalur në gjirin e vogël të Grammata-s. Gjithashtu, një tekst në gjuhën vulgarë (popullorë) flet për zakonin shqiptar të të bërit "vllam". Mbishkrimet vazhdojnë gjer në kohëra të afërta më në, ku më të fundit janë ato të një viti më parë së udhëtimi ynë, pra të vitit 1860. Siç e dimë tashmë, atje ka një ansambël monumentesh, ku udhëtari që do të kishte kohë t'i studionte shkëmbinjtë e Grammata-s, do të bënte të njohura gjëra shumë interesante.

Mjerisht, mbishkrimi i shkruar në gjuhën vulgare apo popullorë, siç shkruan Heuzey, është fshirë, çka është interesante jo vetëm etnografike, por së pari nga ana linguistikë. I kujt shekulli ishte ky mbishkrim? Një enigmë si shumë të tjera që kanë mbetur për historinë shqiptarë...

**MURGJIT E APOLONISË DHE NYMFEU QË HESHTI...**

Kur kishte shkuar në Apolloni, murgjit e atjeshëm i kishin treguar Heuzey-it dhe për ekzistencën e një Nymfeu, (Nymphaeum), i cili lidhej më legjenda që vinin që larg nga bota antikë. Në fakt, kishte qene Herodoti, ai që tregonte pikërisht për Nymfeun e Apollonisë, ku toka nxirrte pareshtur shatërvanë zjarri e avujsh nga nëntoka që nuk shuheshin. Madje i folën dhe për historinë e bariut Evenios, e cila ishte përcjellë nga njëri brez në tjetrin: "Në Apoloni kishte bagëti që i ishin kushtuar diellit. Çdo vit, një nga banorët e zgjedhur, natën ruante bagëtitë. Por një natë, kur ishte rojë Evenios, ujqit kishin ardhur në vathë dhe kishin copëtuar 60 prej tyre. Atëherë, prijësit e Apollonisë, bariut Evenios i krryen sytë. Mirëpo bagëtia filloi të shkretohej dhe tokat të mos prodhojnë më. Njerëzit shkuan të orakujt e Dodonës dhe të Defit dhe u ankuan për këtë. Orakujt u thanë së kjo kishte ndodhur, pasi ata i kishin krryer sytë Evenios. Pra ata duhej të kënaqnin dëshirat e tij në mënyrë që ai vend të bëhej sërish i shenjtë. Njëri nga prijësit e atij vendi u ul një ditë pranë Evenios së verbuar dhe e pyeti si rastësisht së çfarë do të donte në këtë jetë. Evenios i foli atij për toka dhe shtëpinë më të bukur të qytetit. Atëherë ata ia dhanë dhe që atëherë, vendi u bë përsëri i shenjtë."

Lidhur më vëzhgimet e asaj ditë, Honoré Daumet, pati kohë veçse sa të skiconte disa nga basorelievet dhe kokat e mrekullueshme të gjetura aty. Heuzey u mahnit nga shtylla e vetme që kishte mbetur nga Tempulli i Dianës. "Është e vetmja shtyllë greke që gjendet në vend dhe në gjithë zonën e madhe mbi veri të Athinës... Për sa i përket Akropolit, vendosja e tij është e konturuar nga muret mbajtëse dhe nga disa tarraca në një pllajë të kultivuar, e cila më ekstremitetin lokal të kodrinës krijon një pikë dominuese nga ku kemi një pamje të gjerë mbi të gjithë pllajën midis dy lumenjve si dhe mbi detin më larg. Pak më ulët është një platformë ku është vendosur manastiri i Pojanit, që ruan ëndë emrin disi të ndryshuar të Apollonisë së vjetër të Ilirisë". Krahas Daumet, edhe Heuzey vizatonte më laps atë që më vonë do të jetë një lloj gravure e një vendbanimi të hershëm antik. Në hyrje të raportit të misionit të tij, dorëzuar Napolonit të III, Heuzey kishte shkruar: " Sir... Dukë zbritur në rrafshinat e Turqisë qendrore, përmes Via Egnatia-s në gjetëm më pas në bregun e Adriatikut, dy qytete antikë të dorës së parë. Në sajë të një pozicioni të shkëlqyer, përballë Perandorisë, dhe në kryqëzimin e rrugëve ushtarake që lidhte kryeqytetin e Perandorisë në komunikimin më Orientin, Apolonia e Dyrrachium kanë gëzuar një fat më zgjerimin e pushtimit romak. Sot, më gjithë gjendjen e shpërndarë të rrënojave, secila nga këto qytete ruan ëndë një karakter të veçantë, që i përgjigjët roleve të ndryshme që ato kanë luajtur gjatë historisë... "

Heuzey ishte një shkencëtar më përvojë dhe nuhatje të thellë profesionale, dhe shqiptarët i kishte njohur që në udhëtimin e tij të parë në Ballkan, në Thesali, në vitin 1858, atëherë kur shqiptarët e shoqëronin si rojë, (në fillim 12 shqiptarë e pastaj një i vetëm), gjatë udhëtimit të tij për në Larisa e në Meteorë, siç kujtonte ai në shënimet e udhëtimit që i botoi në Paris nën titullin Excursion dans la Thessalie turque en 1858, (Eskursion në Thesalinë turke më 1858). Madje i sëmurë nga ethet, ai kishte qëndruar diku në një fshat arvanitasish, ku i bëri përshtypje, që ndryshe nga turqit, shqiptarët më kostumet e tyre karakteristike, i mbanin gratë pranë tyre dhe nuk i largonin kur vinin të huajt. Ishte gruaja dhe dy vajzat e shqiptarit që u përkujdesën për të. Dhe tani, përsëri shqiptarët ishin ata që po e prisnin më aq bujari. Por Heuzey atë ditë nxitonte. Ai duhej të vëzhgonte sa më shumë, edhe pse dëshira ia kishte që të ndalonte gjatë dhe të hidhte kazmën e parë të arkeologut, çka bëri dhe në Maqedoninë antike, në Philippe e Farsale. "Rrënojat e Apollonisë, - do të shënonte ai nga ky qëndrim i shkurtër, - paraqesin imazhin e një qyteze që gjatë gjithë antikitetit i ka ruajtur traditat e jetës helenike, madje edhe gjatë pushtimit romak. Kur vëzhgojmë objektet që janë grupuar në vendin e dikurshëm të akropolit dhe që formojnë në manastirin e Pojanit në muzë të vërtetë, ndjejmë një gëzim të veçantë të gjendemi këtu si në Greqi. Megjithatë, këto fragmente të grumbulluara pothuaj nga njëzet ndërtime të ndryshme, kanë gjurmët e një stili më pak të ashpër sesa monumentet e shekullit të Perikliut: një "antefix" në mermer që paraqiste dy valltarë të përqafuara nga përdredhja e një palmë, ishte ndoshta shembulli më i shkëlqyer i artit grek "të zbukuruar", që nuk habitemi ta gjejmë gjithashtu në një koloni të Korintit. Në shumë fragmente dorikë dhe veçanërisht në kokën e një luani që ka rënë nga korniza e një tempulli, dukën gjethet dhe ornamentet korintase që pleksen më ornamentet gjeometrike. Një "atlant" prej guri, (trupi i një gjigandi që mban një tempull, L.R.), mjerisht shumë i dëmtuar, i cili ka mbajtur arkitraun e ndonjë portiku, është një dëshmi tjetër e pasurisë së një popullsie të zhvilluar, veçanërisht në ndërtimet publikë. Në gjetëm, gjithashtu, dhe kokën e një gruaje me shami, por vetëm bukuria e kësaj koke mjafton për të treguar së asnjë nga artët e Greqisë antikë nuk degjeneroi në duart e kolonëve të Korintit në këto brigje të largëta të Ilirisë. Apolonia dhe porti afër tij, Oricum, gjurmët e të cilit unë i gjeta, ishte për në fundi i këtij udhëtimi..."

**DEMETRA**

Busti i një gruaje më vello mbi kokë tërhoqi vëmendjen e veçantë të Heuzey-it. Ajo ishte ndryshe nga të tjerat dhe më një dhimbje të madhe në shprehinë e saj. Në fakt, këtë skulpturë e kishte ndeshur më parë kapiteni anglez Martin Leake, i cili kishte vizituar Apoloninë dhe manastirin e Shën Maria-s në shtator të vitit 1805. Në shënimet e tij ai shkruante për një "Bust i një gruaje më vellon e hedhur mbi flokë e që pastaj i kalon në gjoks. Ky bust, thonë murgjit, ishte i përsosur, derisa disa ushtarë të Beratit, menduan së ishte i përshtatshëm për t'u argëtuar, dukë e goditur më mushqetat e tyre, gjë që i shkatërroi hundën e mjekrën..." Pikërisht kjo skulpturë e Demetrës, hyjnisë së të korrave, tokës dhe pjellorisë, nënës së Persefonit, virgjëreshës së Pranverës (të rrëmbyer më pas nga Hades në botën ferrike), kishte mbijetuar gjer ditën që kishte ardhur Heuzey. Ja çfarë do të shkruante ndër të tjera më vonë Heuzey rreth kësaj skulpturë që gjeti në Apoloni në studimin e tij të njohur "Kërkime mbi tipin e Demetrë-s së mbuluar më vello në artin grek", skulpturë të cilën ai e mori më vete dhe e solli në Muzeun e Luvrit. "Monumenti që na shërben si pikënisje në këtë studim është gruaja më vello, në mermer, një fragment i një statujë greke të gjetur në Apoloninë e Epirit dhe që unë e solla në Luvër. Së pari, ajo që e bën këtë kokë të Apolonisë të denjë për t'i kushtuar një vëmendje të veçantë, është qëndrimi i saj i rëndë, por njëherësh, i trashtë e i ëmbël, çka e dallon nga disa lidhje më idealin pagan... Dhe kjo është veçse hyjnia Demetre, ku kulti dhe legjenda, si diçka thelbësore, qëndrojnë në imazhin tragjik të një hyjnie në zi. Në himnin homerik, vello mbi kokë, ishte mbi të gjitha shenjë e dhimbjes dhe e trishtit të zymtë që ajo donte ta fshihte nga vështrimet e të gjallëve. Në shohim së në legjendën dhe misteret e saj, skulptura kërkonte të krijonte një keqardhje për fatkeqësitë e hyjnisë, e dërmuar nga lodhja dhe e dobësuar nga e pangrëna e dhimbja. Dhe kjo dukët si në vizatimin e vazos antike të Poniatovski-t, ku hyjnesha shfaqet në krah të karros së Triptolemeut, siç e shohim dhe në një statujë të Demetrës më vello në muzeun e Luvrit apo në Muzeun e Londrës, ku busti paraqet pikërisht një hyjni më vello në kokë, e njëllojtë për nga zymtësia fetare më kokën e gjetur në Apolloni...

Opinioni i Ditës

# Të sëmurët mendorë, një histori personale pa zgjidhje

Nga Rezearta Çaushaj

(vijon nga faqja 1)




...Jo më shumë se një javë më parë, doktoreshë Shqiponja Rrapaj, iu drejtua motrës sime me fjalët "Do të të nxjerr për leckash përjashta!", kur për të mijtën herë kërkuam shtrimin e vëllait për arsye të sëmundjes mendore të avancuar dhe tendencës për të dëmtuar shëndetin e vet.
E kërkuam të pajisur me rekomandim të mjekut të familjes dhe mjekut të Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor, pasi nëna jonë, njëkohësisht kujdestarja, pësoi goditje cerebrale. Për shkak të stresit ishte diagnoza e saj. Ligjërisht këto rekomandime mjaftojnë.
Ironikisht, ngjarja e ndodhur në fshatin Selenicë të Vlorës, ku një i ri vrau 8 të afërm hapi, midis të tjerash, një debat mbi kujdesin që shteti tregon për personat me sëmundje të shëndetit mendor.
I njëjti debat u hap dy vjet më parë ku një person me histori të shëndetit mendor i preu kokën një fëmije 9 vjeç.
Jo rastësisht, debati përqendrohet vetëm në rastet kur i sëmuri shfaq njëkohësisht edhe sjellje agresive apo të dhunshme, pasi shoqëria ndihet e kërcënuar veçanërisht nga kjo kategori.
Opinionet apo analizat janë nga kënde të ndryshme, por më i fundit që dëgjova ishte z. Skerdi Zykaj, psikolog me profesion, në një intervistë te televizioni FaxNews.
Ai tha se e gjithë shoqëria duhet të angazhohet në përkujdesin ndaj personave të shëndetit mendor (ndonëse vrasësi nuk është klasifikuar me të tilla probleme ende).
Nga eksperienca ime me 2 familjarë me probleme të shëndetit mendor më duhet të them se pohime apo citime të formulave të tilla të gatshme në kontekstin tonë nuk vlejnë fare.

**PËRKUJDESJA E PERSONAVE ME PROBLEME TË SHËNDETIT MENDOR ËSHTË BARRË E FAMILJES. PIKË.**

Nëse ndodh të përplasësh kokën në Spitalin Psikiatrik të Vlorës, siç i ndodh rëndom familjes sime, të përcjellin duke të kujtuar rregulloren për përkujdesjen nga shtëpia të pacientit.
Por rasti konkret bën fjalë për gjendje të rënduar akute të sëmundjes mendore, për të cilët parashikohet ligjërisht trajtimi në spital.
Përkujdesja nga shtëpia nuk është veçse një gjilpërë qetësuese që e vendos të sëmurin në gjumë rëndom.
Ajo nuk merr parasysh asnjë rrethanë familjare, veç faktit që shteti paguan një kujdestar dhe ai duhet të përballojë çdo situatë të mundshme.
Qasja është "Merr këto 100 mijë lekë (duke korruptuar anëtarët e komisionit) dhe mos u duk më!"
Nëse nuk gjenden persona të aftë fizikisht a mendërisht për përkujdesje, nëse familja është e paaftë të përkujdeset për familjarin e sëmurë për shkak të rrethanave të jetës apo për përkujdesin e veçantë që ai kërkon, personi është në mëshirë të fatit. Po ashtu edhe familja.
Nëse familja ka dy persona të sëmurë, kujdestaria jepet vetëm për njërin.
Përkujdesja nga shtëpia nuk merr parasysh situatat familjare me më shumë se një person me probleme të shëndetit mendor apo si ndikon kjo te gjendja e pacientit (të mos flasim për gjendjen e familjes).
Alternativa që ofrohet është që familja ta çojë të sëmurin te Qendra Ditore, ku ai ta kalojë ditën duke fjetur pasi i është bërë qetësues.
Nëse i sëmuri nuk pranon të shkojë atje vullnetarisht, asnjë ndihmë nuk i ofrohet familjes nga shteti.
Nga ana tjetër, Qendra Ditore, e programuar për persona me potencial riintegrimi në shoqëri, përdoret rëndom për të rekomanduar pacient me stad të avancuar të sëmundjes.
Ato aktivitetet për riedukimin e shkathtësimin e pacientit tingëllojnë bukur në letër.
Nuk ka asnjë klasifikim mbi llojin e sëmundjes, nivelin e përkeqësimit, agresivitetin që mund të drejtohet ndaj të tjerëve apo ndaj vetes.
Shumicës së pacientëve iu refuzohet shtrimi me arsyen se nuk kanë agresivitet, por agresiviteti përcaktohet nga doktorët.
Nëse i sëmuri minimalisht nuk zhdëp njeri në dru, doktorët përfitojnë për ta quajtur të parrezikshëm.
Nëse ai ka tendenca të dëmtojë shëndetin e vet Zoti e ruajttë!
Nëse është e pamundur që ai të jetojë në familje, ai i lihet në ngarkim familjes gjithsesi.
Sikur të mos mjaftonte ligji dhe rregullorja problematike, një pjesë e mjekëve ose janë neglizhent ose kërkojnë ryshfet për shërbimin.
Doktoresha Rrapaj, e cituar më lartë, është kapur në aferë ryshfeti si kryetare komisioni para pak vitesh dhe u lirua nga detyra për pak kohë. Ajo është rikthyer në detyrë dhe vazhdon abuzimin, paçka se ka dal edhe në pension.
Doktoreshë Diana Brahimuço po ashtu u kap nga emisioni 'Fiks' në vitin 2012. Jo vetëm e kanë rikthyer, por e kanë ngritur në detyrë.
Fati i të sëmurit dhe të afërmve, e pohoj me gjithë përvojën 30 vjeçare të familjes sime, është rëndom në duar të doktorëve të tillë.
Ato janë të afta të refuzojnë trajtimin me shtrim të pacientit, ndonëse i nevojshëm, edhe për arsyen e pathënë se ky i fundit nuk kujdeset dot për veten.
Pra, kërkohen pacient me diagnozë skizofrenie me standarde, jo dosido.
Nuk po flas për konfliktet që hapin, mungesën e korrektesës apo fyerjet se kur e di që je në dorë të tyre, nuk i llogarit fare. Nëse do të përfillesh apo jo, do të varet vetëm dhe vetëm nga ata pak njerëz të mirë e profesionist që do të takosh (kam në mendje doktoreshë Jonën, Lauretën dhe doktor Stilianon).
Mundësitë e tyre janë të kufizuara e shpesh të paefektshme përballë kolegëve të tyre me pozicion e miq "të fortë", por lehtësimi i përkohshëm të vjen vetëm prej tyre. Është lehtësimi që të ofron humanizmi dhe solidariteti njerëzor.
Ai që mungon në këtë histori është shteti. Ai nuk gjendet gjëkundi.
Sepse të sëmurët mendorë nuk dalin dot t'i thurin elozhe qeverisë në TV. Ata jetojnë më shumë brenda mendjes së tyre.
PS: Historia e familjes sime nuk është histori e veçantë për nga natyra e trajtimit që i bëhet. Pozicioni i saj rëndohet ndoshta nga fakti se kemi dy të sëmurë, por është historia e çdo familjeje që ka persona me sëmundje të shëndetit mendor mes tyre në Shqipëri.

Dje në 'Deutsche Welle'

# E pamundur që BE të jetë pro ndryshimit të status quosë territoriale

Nga Aida Cama

(vijon nga faqja 1)

...të jetë pro
ndryshimeve të status quosë territoriale.

**Deutsche Welle: A është larguar Brukseli dhe Uashingtoni nga politikat e mëparshme që mbështesnin sovranitetin e Kosovës dhe integritetin territorial?**
Michael Leigh: Do të ishte gati e pamundur në Bashkimin Evropian të gjendej një konsensus në favor të ndryshimit të staus quo-së territoriale midis Serbisë dhe Kosovës. Ideja e njohjes së Kosovës në këmbim të përkatësisë territoriale nuk ka gjasa të përkrahet nga serbët dhe kosovarët ose të përkrahet nga pesë vendet anëtare të BE-së, që kanë refuzuar të njohin pavarësinë e Kosovës. Ndarja bazohet në kërkim të puritetit etnik dhe jo nevojës për të jetuar së bashku në një shoqëri multietnike. Kjo mënyrë për arritjen e gjërave ka pasur një histori tragjike në Ballkan dhe nuk përputhet me principet e BE-së. Shtetet anëtare do të jenë shumë vigjilente sa i përket rritjes së presioneve nga jashtë, duke pasur parasysh rolin në rritje të Rusisë dhe Kinës në Ballkan.

**Deutsche Welle: Organizata të shoqërisë civile nga Serbia dhe Kosova janë duke i kërkuar BE të bëjë një deklaratë të qartë kundër ndarjes së Kosovës ose këmbimit të territoreve. Çfarë ka ndër mend të bëjë Bashkimi Evropian?**
Michael Leigh: Mbetet të shihet nëse shtetet anëtare që janë tradicionalisht në favor të Serbisë do të ishin të gatshme të aprovonin një deklaratë të tillë.

**Deutsche Welle: Çfarë është paraparë nga vendet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën, Spanja, Greqia, Qipro, Rumania dhe Sllovakia? A do të çonte një marrëveshje për ndarjen automatikisht në njohjen e Kosovës?**
Michael Leigh: Kundërshtimet e pesë vendeve të BE-së, që nuk e njohin shkëputjen e Kosovës, janë të lidhura me dilemat politike që ata kanë në vendet e tyre dhe nuk kanë domosdoshmërisht si qëllim mbështetjen e Serbisë. Këto kundërshtime do të vazhdojnë të ekzistojnë për një periudhë të konsiderueshme edhe nëse arrihet ndonjë marrëveshje midis Serbisë dhe Kosovës.

**Deutsche Welle: Kush mund të garantojë se Kosova do të marrë një vend në Kombet e Bashkuara nëse arrihet ndonjë marrëveshje?**
Michael Leigh: Ky synim ka të ngjarë të mbetet një aspirate e papërmbushur në një të ardhme të afërt, megjithëse mund të krijohen forma të ndryshme bashkëpunimi.



Michael Leigh është ekspert për politikat evropiane në Fondin Marshall Gjerman. Fondi Marshall Gjerman i Shteteve të Bashkuara (GMF) është një organizatë joqeveritare e krijuar nga Gjermania për të kujtuar Planin Marshall. Organizata ka si qëllim forcimin e bashkëpunimit ndëratlantik.

## HOROSKOPI

### DASHI
Sot mund të përfshiheni nga konfuzioni veçanërisht nëse keni intuitë të fortë. Disa ndjesi të veçanta mund të bëjnë që të ndiheni jo në formën e duhur. Mendoni pozitivisht.

### DEMI
Një ndjenjë e fortë miqësie që keni me një person mund t'ju fusë në një situatë prekëse sot. Ky person mund t'ju kërkoje të bëni diçka për të, por në këtë moment është e vështire, thuajse e pamundur.

### BINJAKET
Disa informacione që mund të merrni nga disa miq mund t'ju shqetësojnë pak lidhur me situatën financiare. Mund të kërkoni të arrini një qëllim, i cili mund të mos realizohet për momentin.

### GAFORJA
Sot mund të merrni disa vizione të çuditshme, por mos mendoni shumë për këtë. Ato mund të jenë vetëm imazhe nga e kaluara. Nuk bëhet fjalë për profeci apo parashikim i të ardhmes suaj.

### LUANI
Sot mund ta keni të vështirë të përqendroheni të punët e shtëpisë. Mendja juaj është e fokusuar në ngjarje me emocionuese. Bëni atë që ju thotë zemra. Punët mund të presin.

### VIRGJERESHA
Zakonisht keni një marrëdhënie të fortë më njerëzit që keni pranë, por sot kjo pjesë nuk do të funksionojë. Mund të merrni disa mesazhe që mund t'ju zhysin ne konfuzion.

### PESHORJA
Mos u përpiqni të jepni shpjegime të gjata për disa ngjarje keqkuptime. Nëse nuk ju besojnë, më mirë shmangni debatet dhe lërini ata t'i gjejnë vetë sqarimet.

### AKREPI
Sot mund të jeni shume krijues duke bërë që të nxirrni në pah anën tuaj prej një artisti. Është dita e duhur për të bashkëpunuar me të tjerët për të vënë në zbatim idetë tuaja.

### SHIGJETARI
Çështjet romantike do të shkojnë mirë për ju sot, edhe pse mund të keni disa dyshime. Mos lejoni që pasiguritë të dëmtojnë lidhjen tuaj, e cila është duke funksionuar.

### BRICJAPI
Sot do të keni kaq shumë gjëra për të bërë në shtëpi sa që nuk do të dini nga t'ia filloni. Mund të kërkoni ndihmën e pjesëtarëve të familjes në mënyrë që ta kaloni këtë situate.

### UJORI
Sot do të zbuloni disa gjëra të reja dhe informacione interesante. Diskutimet me miqtë do të rezultojnë pozitive. Edhe gjendja emocionale do të jetë e mirë për të lindurit në shenjën tuaj.

### PESHQIT
Ndiheni pak i shqetësuar, aq sa nuk e keni mendjen kur ju flasin të tjerët. Kjo do të jetë e përkohshme. Mos u shqetësoni nëse njerëzit mendojnë se po tregoheni i pasjellshëm.

Vijon lëvizja antiqeveritare në Bukuresht, mijëra protestues vijnë nga gjithë Europa

# Dita e tretë e protestës në Rumani, plagosen 450 persona

## *Emigrantët rikthehen në atdhe: Na largoi qeveria!*



Mijëra rumunë kanë marrë pjesë sërish në protesta kundër qeverisë në kryeqytetin rumun, Bukuresht, një ditë pas përplasjeve që shkaktuan më shumë se 450 persona të plagosur. Protesta pranë zyrave të qeverisë ka qenë e zhurmshme por e paqtë. Protesta të ngjashme janë shënuar dhe në qytete si Cluj, Sibiu, Timisoara dhe Iasi. Më shumë se 50 mijë persona dolën në rrugë kundër asaj që ata e përshkruajnë si korrupsion masiv, pagave të ulëta dhe kundër përpjekjeve të partisë në pushtet për të dobësuar sistemin gjyqësor. Shumë prej demonstruesve ishin emigrantë rumunë që janë kthyer nga e gjithë Evropa për të shprehur zemërimin e tyre në qeveri. Ata udhëheqin tubimet pasi thonë se u detyruan të largohen nga vendi për shkak të korrupsionit.

Ka degjeneruar në dhunë e përleshje me policinë, protesta anti-qeveritare në Bukuresht. Qindra manifestues u përleshën ashpër me policinë në sheshin përpara Parlamentit rumun. Të paktën 450 persona u plagosën, mes të cilëve mbi 20 policë. Përleshjet nisën para mesnatës së djeshme, pasi policia ndërhyri për të shpërndarë turmën e madhe prej rreth 60 mijë manifestuesish. Manifestuesit hodhën parulla kundër qeverisë socialdemokrate, të cilën e akuzojnë si të korruptuar. Një nga motivet e protestës ishte shkarkimi i prokurores së famshme antikorrupsion Laura Kovesi. Në korrik, Parlamenti miratoi shkarkimin e saj me shumicë votash, duke detyruar edhe presidentin Klaus Johanis të dekretojë shkarkimin e saj, pavarësisht se ai është shprehur publikisht kundër. Në punën e saj 5 – vjeçare, Kovesi ka ngritur akuza për korrupsion për dhjetëra deputetë dhe ministra të qeverive socialdemokrate. Ministri aktual i Drejtësisë Tudorel Toader i konsideroi sulme politike proceset e hapura nga Kovesi, që po dëmtonin imazhin ndërkombëtar të Rumanisë. Socialdemokratët kanë miratuar muajt e fundit disa ligje, që reduktojnë pavarësinë e gjyqësorit, çka është kritikuar ashpër edhe nga Bashkimi Europian. Mijëra protestues antiqeveritarë kanë mbushur rrugët e sheshet e Rumanisë gjatë mbrëmjes së të premtes. Mediat vendase shkruajnë se të paktën 30,000 njerëz duke përfshi edhe mijëra rumunë që punojnë jashtë vendit, protestuan në kryeqytetin rumun në Bukuresht. Protestuesit hodhën shishe dhe pllakat e rrugës kundrejt kordonit të policisë, por u përballën me gaz lotsjellës, dhe sprait djegës. Mbi 100 protestues dhe efektivë policie mbetën të plagosur si pasojë e përleshjeve. Duke mbajtur flamuj rumunë dhe të Bashkimit Europian, protestuesit kërkojnë dorëheqjen e qeverisë, pasi kundërshtojnë përpjekjet e Partisë Social Demokrate për të dobësuar gjyqësorin, por edhe për pagat e ulëta e korrupsionin në vend. Protesta kundër partisë në pushtet PSD janë zhvilluar prej disa muajsh në Rumani. Rreth 150 mijë shtetas rumunë u mblodhën në Bukuresht vitin e kaluar, pasi qeveria kaloi një dekret që mund të lironte të burgosurit e dënuar mbi akuza për korrupsion. Sistemi gjyqësor rumun ndërkohë është vënë nën vëzhgim të veçantë nga Brukseli.

**PROTESTA E VITIT TË KALUAR:**
Rreth 150 mijë shtetas rumunë u mblodhën në Bukuresht vitin e kaluar, pasi qeveria kaloi një dekret që mund të lironte të burgosurit e dënuar mbi akuza për korrupsion. Sistemi gjyqësor rumun ndërkohë është vënë nën vëzhgim të veçantë nga Brukseli.

**ARSYET E PROTESTËS:**
Manifestuesit hodhën parulla kundër qeverisë socialdemokrate, të cilën e akuzojnë si të korruptuar. Një nga motivet e protestës ishte shkarkimi i prokurores së famshme antikorrupsion Laura Kovesi. Në korrik, Parlamenti miratoi shkarkimin e saj me shumicë votash, duke detyruar edhe presidentin Klaus Johanis të dekretojë shkarkimin e saj, pavarësisht se ai është shprehur publikisht kundër.

**450**
**TË PLAGOSUR:**
Qindra manifestues u përleshën ashpër me policinë në sheshin përpara Parlamentit rumun. Të paktën 450 persona u plagosën, mes të cilëve mbi 20 policë. Përleshjet nisën para mesnatës së djeshme, pasi policia ndërhyri për të shpërndarë turmën e madhe prej rreth 60 mijë manifestuesish.

## Zjarr i madh në Evia të Greqisë, dy fshatra evakuohen me urdhër



**GREQI-** Një zjarr i madh ka përfshirë pasditen e sotme ishullin Evia në Greqi. Forcat e zjarrfikëseve kanë mbërritur në vendngjarje dhe po punojnë për shuarjen e flakëve, por sipas mediave greke, erërat e forta po e bëjnë zjarrin të pakontrollueshëm. Raportohet se tymi ka mbuluar ishullin Evia, Athinën dhe Kinetën. Sakaq, policia po bën evakuimin e banorëve të dy fshatrave për të shmangur ndonjë rrezik në jetë njerëzore. Sipas "protothema.gr", rreth 250 banorë të dy fshatrave që rrezikohen nga zjarri janë evakuuar nga banesat e tyre. Zona më e prekur është ajo e Gujaratit. Banorët e evakuuar janë mbledhur në një vend të sigurt në manastirin e Panagia Gorgoupikoou. Zjarri është i afërt me shtëpitë e para të dy vendbanimeve, ndërsa thonë se erërat që fryjnë në rajon janë veçanërisht të forta dhe të shtyjnë zjarrin më përpara. Në lufte me zjarrin janë 171 zjarrfikës me 57 mjete dhe 6 helikopterë.



## Arrestohet imami Asllan Bajraktari, Kërcënoi vëllain e presidentit Thaçi

Asllan Bajraktari, imam në xhaminë e Jashicës është personi I arrestuar për kërcënim ndaj familjes së presidenti Kosovar Hashim Thaçi. Ai u arrestua para dy ditësh me dyshimin se ka kërcënuar familjen e presidentit në fshatin Burojë të Skenderajt. Sipas burimeve të kallxo.com, ai ka shkuar në shtëpinë e familjes ku ka kërcënuar familjarët. Arsyeja e kërcënimit sipas këtyre burime është pakënaqësia e qytetarit me ndarjen e një subvencioni në bujqësi. Lajmi është konfirmuar edhe nga prokurorja Fikrie Sylejmani, e cila është duke e hetuar rastin. "Vëllai i presidentit është ankuar për kërcënim", ka thënë prokurorja. Ajo ka shtuar se motivi i kërcënimit është pakënaqësia që personi i dyshuar e kishte rreth një granti. "Personi është arrestuar dhe unë kam kërkuar paraburgim për të", ka thënë prokurorja Sylejmani. Lajmi u konfirmua dhe nga Avni Zaiti, zëdhënës i Policisë në Mitrovicë.

SHKURT

### Kryenin akte të pahijshme në publik, kalimtari njofton policinë.

Një kalimtar është shokuar kur ka parë një grup personash që bënin akte të pahijshme në një park në mes të ditës. Ngjarja ka ndodhur në Cardiff të Uellsit. Qytetari filmoi 4 personat, të cilët kryenin orgji dhe pamjet i denoncoi në polici. Ai po shkonte në shtëpi pasi kishte përfunduar orarin e punës, kur pa në mes të parkut veprime të turpshme. Sipas dëshmitarit, grupi i personave ishin pothuajse të zhveshur dhe sjellja e tyre ishte krejtësisht e papranueshme. Këtë veprim, thotë ai, e panë edhe kalimtarë të tjerë, të cilët kërkonin të gjenin punonjës policie për t'i denoncuar, për shkak se në park kishte shumë fëmijë në atë orar. Për këtë ngjarje të pahijshme është informuar edhe Këshilli i Cardiff që menaxhon parkun. Këshilli bëri me dije se incidenti është denoncuar në polici.

### Vdes foshnja 10-muajshe, gjyshi e harroi në sediljen e makinës

Një vajzë e vogël 10-muajshe ka humbur jetën pasi gjyshi e harroi në sediljen e pasme të makinës për 8 orë në një temperaturë 30 gradë Celsius. Ngjarja ka ndodhur në Majorca të Spanjës. Policia arrestoi 56-vjeçarin me dyshimin për vrasje, por më pas e liroi me kusht. Ai u tha hetuesve se harroi që ishte me mbesën në makinë kur parkoi në orën 07:00 të mëngjesit për të shkuar në kafe, dhe fatkeqësisht zbuloi gabimin e tij fatal kur u kthye në orën 15:00. Një mjek kalimtar që u gjend aty pranë, tentoi ta ringjallte foshnjën duke i dhënë ndihmën e parë. Më pas aty mbërritën edhe ekipet e emergjencës. Por fatkeqësisht ishte shumë vonë për vogëlushen. Nga hetimet e deritanishme është mësuar se foshnja ka qenë në gjumë kur gjyshi i saj e harroi në makinë. Gjykata tashmë do të duhet të vendosë nëse do të ngrejë padi ndaj 56-vjeçarit apo jo.

# Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Dillon aktor.
5. Një listë që zgjidhet nga regjisori
9. Sigla e tritolit.
12. Kapiteni që ndiqte balenën Moby Dick.
14. Është spektator i yni.
16. Fillojnë lejen
17. Një sinjal akustik.
19. Një parashtesë për... përtej.
20. Është partia e Sali Berishës.
23. Kanë organizatën Hamas.
24. Gëlojnë nga murgjit.
25. Në teori kur mungon ti.
27. Inicialet e Gide.
28. Inicialet e Asimov.
29. Nisen pa ne.
31. Kreshniku i volejbollit.
36. Kufijtë e tokës.
37. Mund të jenë autonome të tilla.
38. Britma e Arkimedit.
41. Fillojnë vetëm.
42. Bota jashtë ëndrrës.
44. Mund të jenë ushtarake.
46. Italia në Internet.
47. Gjysmë atomik.
49. Janë prova inteligjence
50. Një libër hartash.
51. Clapton i muzikës.

VERTIKAL
1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një... bombë tenistike.
3. Fillojnë themelet.
4. Mund të jetë klasifikimi.
6. Një letër... kampioni.
7. Është pozicioni për gjumë.
8. Janë diktatorët despotikë.
9. Një kryeqytet afrikan.
10. Qe mesfushor i famshëm i Ajax.
11. Ekstreme në tenis.
13. Është e dendur në xhungël.
15. Është brinjë në skuadër.
18. Është pako që dërgohet.
20. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
21. Bëjnë taktika me taka.
22. Vetot pa kufij.
23. Persekutonin romakët.
24. Është gri ajo e trurit.
26. Një mund të jetë spiunzhi.
30. Janë vendet për nisje.
32. Me to bëjnë torta.
33. Janë katër në kitarë bas.
34. Institucione Urbane Rajonale.
35. Priten me lotë në sy.
39. Një rreth pa ekstreme.
40. Gjysmë kasate.
41. Është cilësia.
43. Ente Tregtare Lokale.
45. Një pjesë e territorit.
48. Në hyrje të oazit.

# Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Jagger i Rolling Stones.
4. Zanore për kuaj.
6. Janë dhelpra.
11. Inicialet e Lendl ish tenist.
12. Kufizojnë rastet.
14. Mbyllen me epilog.
16. Është simbol ngadalësie, por jo breshkë.
18. Gjysmë njeriu.
20. Janë fruta ekzotikë.
21. Një minierë e vjetër.
23. Ata tanë ishin ilirë.
24. Masat pa kufij.
25. Një gëzim i madh.
26. Agjenci Ndërmjetëse Përmet
27. Është godinë në miniaturë
29. Film i Ridley Scott
31. Duken të gjata në pritje.
32. Njëzetmijë... në det në një libër të Jules Verne.
34. Është kreu i bandës.
36. Ndahen nga ortakët.
38. Është numri një.
41. Janë trupa qiellorë të tillë.
44. Kanë dhoma për t'u zënë.
46. Tri çupa në poker.
47. As unë, as ai.
48. Janë vitet.
49. Pak amatoriale.

VERTIKAL
1. Një legjendë.
2. Përfundojnë një stil.
3. Nuk e ulin kokën.
5. Këndohen në opera.
6. Janë tek në Somali
7. Është lloj papagalli.
8. Mbyllin komentin.
9. Është e parë për prodhim.
10. Kush ka do të pijë.
13. Janë binarë.
15. Rolet pa ret.
16. Vihen për të mbyllur të tilla.
17. Janë tek në mantel.
19. Salgari që krijoi Sandokan.
20. Një stinë e ngrohtë.
22. Janë pamje nga puna.
26. Një fjalë goxha.
27. Ato Ëilliams janë teniste
28. Ishin të parët tanë.
29. Janë edhe ato polare.
30. Fillojnë nazet.
33. Inicialet e Triolet.
36. Një bëhet me pozë.
37. Mbyllin punimet.
39. Ndodh në kufij.
40. Perignon i champagne-s.
42. Është iks ajo e sulmit.
43. Enti europian i hapësirës.
45. Fillojnë lehtë.



# Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

# SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 6 | | | 2 | 5 | 7 | 4 | |
| | 4 | | | 6 | | | 1 | |
| 5 | | | | 7 | 9 | 2 | | |
| 8 | 3 | | | 4 | | 1 | | |
| | | | 7 | | | | 2 | |
| | | | 8 | | | | 6 | |
| | 1 | 9 | | | | 4 | | |
| 6 | 2 | 7 | | 8 | | | | |
| | | | | | | | 9 | |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 8 | 9 | 2 | 4 | 3 | 5 | 7 | 6 |
| 2 | 4 | 7 | 6 | 5 | 8 | 3 | 1 | 9 |
| 3 | 5 | 6 | 9 | 7 | 1 | 2 | 4 | 8 |
| 9 | 3 | 4 | 8 | 1 | 7 | 6 | 2 | 5 |
| 5 | 6 | 2 | 3 | 9 | 4 | 1 | 8 | 7 |
| 7 | 1 | 8 | 5 | 2 | 6 | 9 | 3 | 4 |
| 4 | 9 | 1 | 7 | 3 | 5 | 8 | 6 | 2 |
| 6 | 7 | 5 | 1 | 8 | 2 | 4 | 9 | 3 |
| 8 | 2 | 3 | 4 | 6 | 9 | 7 | 5 | 1 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

# Argëtim filozofik

- Për çdo rezultat ka një shkak. Gjeni dhe përballohuni me shkakun, jo duke u përpjekur për të përcaktuar rezultatin, pasi nuk ka fund për të dytën.
- Të rinjtë dinë çfarë nuk duan, para se ata të dinë se çfarë duan.
- Të gjithë mendojnë të ndryshojnë botën, por askush nuk është duke menduar për të ndryshuar veten.
- Njerëzit që kafshojnë dorën e atij që i ushqen zakonisht lëpijnë këpucët e atyre që i godasin.

Argëtim filozofik



# KRIPTOSKEME

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 S | 4 A | 15 F | 8 O | ■ | 14 | 4 | ■ | 14 | ■ | 7 | 4 | 15 |
| 4 | 11 | 4 | ■ | 1 | 8 | 12 | 2 | 3 | 14 | 5 | ■ | 10 |
| 10 | ■ | 1 | ■ | 4 | 1 | 2 | 8 | 10 | 6 | 4 | 7 | 5 |
| 4 | 7 | ■ | 1 | 7 | 5 | 8 | 9 | 4 | 2 | 10 | 4 | ■ |
| 15 | 3 | 1 | ■ | 6 | 2 | 10 | 5 | 2 | 6 | ■ | ■ | 12 |
| ■ | 7 | 1 | 11 | 13 | 5 | ■ | 1 | 5 | ■ | 17 | 15 | 1 |
| 17 | 3 | 10 | 13 | 3 | ■ | 4 | 4 | ■ | 4 | 10 | 6 | 3 |
| 4 | ■ | 2 | 4 | 7 | ■ | 11 | ■ | 6 | 10 | 4 | 2 | 4 |
| 12 | 1 | 5 | 16 | 4 | 10 | 5 | ■ | 4 | 4 | ■ | 8 | 16 |
| 14 | 4 | 7 | 4 | ■ | 8 | 14 | 5 | ■ | 17 | 3 | 10 | 10 |
| 4 | 11 | 4 | 7 | 6 | 2 | 6 | 1 | 5 | ■ | 7 | 5 | 4 |
| 2 | 4 | 2 | 5 | ■ | 4 | 1 | 2 | 8 | 10 | 6 | ■ | 2 |

# KRIPTOSKEME

*Përgjigja e numrit të djeshëm*

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| K | O | D | I | ■ | ■ | A | D | ■ | ■ | P | A | L |
| A | R | E | S | ■ | T | ■ | I | S | M | ■ | L | A |
| N | A | D | ■ | H | E | R | E | T | I | K | E | T |
| I | R | ■ | M | O | N | I | T | O | R | I | ■ | ■ |
| B | ■ | K | A | P | I | T | A | L | I | S | T | E |
| A | ■ | L | A | P | S | A | T | ■ | A | ■ | A | T |
| L | E | A | ■ | E | T | ■ | ■ | L | M | ■ | T | I |
| I | ■ | S | ■ | R | E | I | N | E | ■ | T | I | M |
| ■ | P | I | S | ■ | ■ | S | O | D | A | ■ | M | O |
| S | E | K | R | E | T | ■ | L | ■ | ■ | G | O | L |
| A | L | E | ■ | L | O | N | D | R | A | ■ | R | O |
| T | E | T | ■ | A | B | D | E | R | A | ■ | E | G |

# PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | O | K | A | T | ■ | L | U | ■ | F | R | A | N | Z |
| A | R | E | S | ■ | F | I | ■ | M | ■ | ■ | ■ | ■ | A |
| L | I | N | ■ | V | E | N | T | I | L | A | T | O | R |
| L | ■ | E | P | E | R | D | I | T | S | H | M | E | ■ |
| J | ■ | T | E | R | R | O | R | I | S | T | E | T | ■ |
| A | S | A | ■ | M | A | R | A | ■ | ■ | ■ | R | ■ | S |
| ■ | H | ■ | L | O | R | E | N | ■ | M | A | R | A | T |
| H | A | M | E | S | I | ■ | ■ | P | A | R | E | T | I |
| U | R | I | T | H | ■ | S | U | R | R | A | T | ■ | N |
| T | I | R | O | I | D | E | T | ■ | I | T | ■ | V | O |
| I | F | ■ | N | ■ | I | T | A | K | A | ■ | S | A | R |
| M | ■ | M | E | N | T | E | ■ | S | H | T | A | T | E |

FJALEKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | O | K | A | T | ■ | L | U | ■ | F | R | A | N | Z |
| A | R | E | S | ■ | F | I | ■ | M | ■ | ■ | ■ | ■ | A |
| L | I | N | ■ | V | E | N | T | I | L | A | T | O | R |
| L | ■ | E | P | E | R | D | I | T | S | H | M | E | ■ |
| J | ■ | T | E | R | R | O | R | I | S | T | E | T | ■ |
| A | S | A | ■ | M | A | R | A | ■ | ■ | ■ | R | ■ | S |
| ■ | H | ■ | L | O | R | E | N | ■ | M | A | R | A | T |
| H | A | M | E | S | I | ■ | ■ | P | A | R | E | T | I |
| U | R | I | T | H | ■ | S | U | R | R | A | T | ■ | N |
| T | I | R | O | I | D | E | T | ■ | I | T | ■ | V | O |
| I | F | ■ | N | ■ | I | T | A | K | A | ■ | S | A | R |
| M | ■ | M | E | N | T | E | ■ | S | H | T | A | T | E |

# Thënie të mençura

- Ju shihni lart, kur kërkoni të lartësoheni. Por unë shoh poshtë sepse jam lart.
- E vërtetë është: e dashurojmë jetën, ama jo sepse jemi mësuar me të, por sepse jemi mësuar të dashurojmë.
- Gjithnjë ka pak çmendi në dashuri. Por gjithnjë ama, ka ca arsye në cdo çmendi.
- Mungesa e pasionit e shuan etjen për dije. Shpirtrave të akullt nuk u besoj. Ai që di të gënjejë, nuk di ç'është e vërteta.



GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
RUSSIA 2018
LAJME
KALENDARI
www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al